



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 93 Akti

Nr. 97 Vendimi

Tiranë më, 10.01.2019

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Firdes Shuli	Kryesuese
Etleda Çiftja	Anëtare
Roland Ilia	Relator

me sekretare gjyqësore, znj. Olsida Goxhaj, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar Branko Hrvatin, në Tiranë, më 08 janar 2019, ora 15:30 dhe datë 10 janar 2019, ora 12:00, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKT I RIVLERËSIMIT : **Z. Arben Zefi**, gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe njëkohësisht kryetar i kësaj gjykate.

OBJEKTI : **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE : **Nenet 179/b, A, Ç, D, DH, Ë, të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, të ndryshuar, me ligjin nr. 76/2016, datë 22.07.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”;
Ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;
Ligj nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, komisionerin Roland Ilia, subjektin e rivlerësimit, z. Arben Zefi, vëzhguesin ndërkombëtar, si dhe pasi shqyrtoi në tërësinë e saj çështjen që i përket rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit, z. Arben Zefi, i cili në seancën dëgjimore publike kërkoi konfirmimin e tij në detyrë,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT PROCEDURALE

1. Subjekti i rivlerësimit, z. Arben Zefi, ushtron detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, duke qenë njëkohësisht edhe kryetar i kësaj gjykate. Në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit ex officio.

2. Bazuar në nenin 14, pika 2, të ligjit nr. 84/2016 dhe në Rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin të Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni), ka hedhur shortin, më datë 15.01.2018, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit, z. Arben Zefi, do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues me nr. 1, i përbërë nga komisionerët Etleda Çiftja, Roland Ilia dhe Firdes Shuli. Relator i çështjes, u zgjodh me short, komisioneri Roland Ilia.

3. Inspektorati i Lartë i Deklarimit të Kontrollit Pasurisë dhe Interesit (në vijim “ILDKPKI”) ka kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar me shkresën, nr. *** prot., datë 08.01.2018, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016.

4. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016. Për këtë qëllim DSIK-ja për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, fillimisht ka dërguar një raport me shkresën, nr. *** prot., datë 02.11.2017, dhe më pas ka dërguar një raport të dytë me shkresën, nr. *** prot., datë 25.04.2018, për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016 dhe deklasifikuar me vendim të KDZH-së, nr. *** prot., datë 09.05.2018

5. Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë (në vijim “IKLD”), ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar me shkresën, nr. *** prot., datë 27.12.2017.

6. Menjëherë me hedhjen e shortit, trupi gjykues administroi:

- raportin e vlerësimit të pasurisë sipas neneve 31 - 33 të ligjit nr. 84/2016, të hartuar nga ILDKPKI-ja;
- raportin e vlerësimit të figurës sipas neneve 34 - 39 të ligjit nr. 84/2016 nga DSIK-ja;
- raportin e vlerësimit profesional sipas neneve 40 - 44 të ligjit nr. 84/2016 nga IKLD-ja.

7. Me vendimin nr. 1, datë 24.01.2018, trupi gjykues, vendosi të fillojë hetimin administrativ sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit, z. Arben Zefi, në lidhje me vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe rivlerësimin e aftësisë profesionale, si dhe caktoi kryesuesin e trupës gjykuese, komisioneren Firdes Shuli. Të gjithë anëtarët kanë deklaruar mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit.

8. Me vendimin nr. 2, datë 06.12.2018, trupi gjykuese, vendosi (i) të përfundojë hetimin paraprak në lidhje me vlerësimin e pasurisë dhe të figurës së subjektit të rivlerësimit, z. Arben Zefi; (ii) t'i njoftojë subjektit të rivlerësimit se provat e grumbulluara për këto dy kritere, kanë nivelin e provueshmërisë sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, dhe atij i ka kaluar barra e provës mbi rezultatet e hetimit, duke i vënë në dispozicion rezultatet paraprake të hetimit, në bazë të paragrafit 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, dhe nenit 52 të ligjit nr. 84/2016; (iii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit për t'u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenet 47 të ligjit nr. 84/2016, neneve 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurës Administrative; (iv) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtën për t'u njohur me dosjen, të drejtën për të kërkuar marrjen e provave të tjera ose thirrjen e dëshmitareve, si dhe afatin ditor brenda të cilit mund t'i ushtrojë këto të drejta.

9. Më datë 13.12.2018, subjekti i rivlerësimit, njoftoi në rrugë elektronike dhe vuri në dispozicion të Komisionit, parashtrësë me pretendimet e tij duke kërkuar shtyrjen e afatit për dorëzim të dokumentacionit shtesë. Kërkesa e subjektit u pranua duke u shtyrë afati për dorëzimin e dokumentacionit shtesë më datë 20.12.2018.

10. Me vendimin nr. 3, datë 13.12.2018, trupi gjykues vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit, z. Arben Zefi, në seancë dëgjimore në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, më datë 20.12.2018, ora 11:00, pranë Pallatit të Koncerteve (ish Pallati Kongreseve), salla B, kati 0 (underground), Tiranë.

11. Më datë 18.12.2018 nga ana e subjektit të rivlerësimit u kërkuar shtyrja e seancës dëgjimore duke kërkuar kohë për të dorëzuar prova shtesa. Me vendim nr. 4, datë 19.12.2018, trupi gjykues pranoi kërkesën e subjektit duke vendosur shtyrjen e seancës për në datën 08.01.2019, ora 15:30.

12. Më datë 08.01.2019, ora 15:30, u zhvilluar seanca dëgjimore për subjektin e rivlerësimit, z. Arben Zefi

13. Më datë 09.01.2019, në orën 16:30, sipas procesverbalit të mbajtur me këtë datë dhe në këtë orë, trupi gjykues, sipas nenit 55, pika 5, të ligjit nr. 84/2016, ka zhvilluar bisedimet për marrjen e vendimit ndaj subjektit të rivlerësimit, dhe përfundimin e procesit të rivlerësimit, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Branko Hrvatin. Vendimi për përfundimin e procesit të rivlerësimit dhe vendimi në lidhje me subjektin e rivlerësimit, është marrë me votim të hapur dhe unanim të këtij trupi, më datë 09.01.2019, në orën 17:30.

14. Më datë 10.01.2019, në orën 10:08 minuta, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur shkresën ku kërkon dorëheqjen nga detyra, protokolluar pranë Komisionit, me nr. *** prot., datë

10.01.2019, me anë të të cilës deklararon se: *“Të nderuar anëtarë të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, znj. Firdes Shuli, z. Roland Ilia, znj. Etleda Çiftja.*

Unë Arben Ëngjëll Zefi, me detyrë gjyqtar në Republikën e Shqipërisë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, dhe Kryetar i kësaj gjykate, në bazë të nenit G, ANEKSI I KUSHTETUTËS SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, për rivlerësimi kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, dhe të VENDIM NR. 78, DATË 12.12.2017, të GJYKATËS KUSHTETUESE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, paraqes para Jush dorëheqjen nga detyra i Gjyqtarit në Republikën e Shqipërisë. Tiranë, më datë 10 janar 2019”

Referuar kërkesës për dorëheqje si me lart, trupi gjykues vlerëson se: sipas pikës 1 të nenit 65 të ligjit nr. 96/2016 *“Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”*, kërkesa e dorëheqjes duhet të paraqitet përpara Këshillit përkatës. Sipas pikës 2 të nenit 65 të këtij ligji, kjo dorëheqje i jep efektet ligjore, në fund të muajit pasardhës nga dita kur Këshilli merr deklarimin me shkrim të dorëheqjes.

Ndërkohë, më datë 09.01.2019, në orën 16:30, sipas proces verbalit të mbajtur me këtë datë dhe me këtë orë, trupi gjykues, sipas nenit 55, pika 5, të ligjit nr. 84/2016, ka zhvilluar bisedimet për marrjen e vendimit ndaj subjektit të rivlerësimit, dhe ka marrë vendimin, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar.

Vendimi për përfundimin e procesit të rivlerësimit dhe vendimi në lidhje me subjektin e rivlerësimit, është marrë me votim të hapur dhe unanim të këtij trupi gjykues, më datë 09.01.2019, ora 17:30.

Bazuar në pikën 6 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, sot më datë 10.01.2019, ora 12:00, seanca dëgjimore konsiderohet e përfunduar dhe shpallet vendimi për subjektin e rivlerësimit, z. Arben Zefi.

15. Në përfundim të seancës dëgjimore, bazuar në pikën 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit: *“Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit dhe vendimi merret bazuar në një ose disa prej kritereve, në vlerësimin e përgjithshëm të tre kritereve, ose në vlerësimin tërësor të procedurave”*, trupi gjykues vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Arben Zefi, bazuar në dy komponentë, atë të vlerësimit të pasurisë dhe kontrollit të figurës.

II. SEANCA DËGJIMORE

Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore me njoftimin e bërë elektronikisht më datë 13.12.2018.

Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, më datë 08.01.2019, ora 15:30, në adresën: Pallati i Koncerteve (ish Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (underground), Tiranë, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Branko Hrvatin

Në këtë seancë, subjekti i rivlerësimit u paraqit personalisht dhe kërkoi të përfaqësohej nga avokat, z. Ardian Visha. Ai parashtrroi shpjegimet e tij në seancë, si dhe i depozitoi ato me shkrim pranë Komisionit.

Në përfundim, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

Z. Arben Zefi, ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit ndaj tij, duke u përgjigjur kur është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ. Ai ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni, si dhe ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur. Subjekti i rivlerësimit ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

Procesi i rivlerësimit që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Aneksit të Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016.

A. VLERËSIMI I PASURISË

1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja.

Në përputhje me nenin 33, pika 5, të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit, z. Arben Zefi, pasi ka përfunduar procedurat e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së tij dhe personave të lidhur, si dhe ka vënë në dispozicion të Komisionit dosjen me dokumentet e administruara.

Në përfundim të procesit të vlerësimit të pasurisë nga ky institucion, është konstatuar se:

- a) *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- b) *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- c) *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- d) *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- e) *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni.

Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) provat e dorëzuara nga vetë subjekti pranë ILDKPKI-së në “Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar, “Vetting”;
- b) raportin e dorëzuar pranë Komisionit nga ILDKPKI-ja;
- c) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016;
- d) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik;
- e) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit;

Në “Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar, “Vetting”, të dorëzuar pranë ILDKPKI-së, më datë 24.01.2017, subjekti i rivlerësimit deklaroi këto pasuri (të paluajtshme dhe të luajtshme):

1. Apartament banimi, me sipërfaqe 132,8 m², ndodhur në, Rr. “****”, Shkodër, blerë në shumën prej 4,355,840 lekësh, fituar me kontratë shitblerje pasurie, nr. ***, datë 27.03.2005.

Burimi i Krijimit sipas deklaratës “Vetting”:

Subjekti i rivlerësimit **nuk ka deklaruar burimin** e të ardhurave për blerjen e këtij apartamenti, detyrim i parashikuar nga Aneksi D i Kushtetutës dhe nenet 30 - 32 të ligjit nr. 84/2016.

1.1 Hetimi i kryer nga Komisioni¹

1.2 Arsyetim ligjor

1.2.1 Subjekti i rivlerësimit, **më datë 27.03.2005**, me kontratë shitblerje nr. ***, ka blerë një apartament banimi me sipërfaqe 132.8 m². Në këtë kontratë përcaktohet se: shuma prej 4,355,840 lekësh **është likuiduar totalisht** nga blerësi dhe pala shitëse pranoi se e mori gjithë shumën dhe nuk paraqet asnjë pretendim për të.

1.2.2 Subjekti i rivlerësimit në deklaratën “Vetting” nuk kishte deklaruar burimin e ligjshëm të ardhurave për këtë apartament për këtë arsye gjatë hetimit administrativ atij iu kërkua të deklaronte burimin e të ardhurave për blerjen e apartamentit. Në përgjigjen e tij subjekti deklaroi se burimi për blerjen e këtij apartamenti kanë qenë kursimet e tij dhe të bashkëshortes të përfituara nga pagat dhe të ardhurat e përfituara nga shitja e apartamentit, pasuria me nr. ***, ZK ***, Bashkia Shkodër.

Deklarimi i subjektit të rivlerësimit se si burim për blerjen e këtij apartamenti ka përdorur të ardhurat nga shitja e apartamentit të mëparshëm nuk është i saktë pasi ky apartament është

➤ ¹ **Shkresë nr. *** prot., datë 10.04.2018, drejtuar të gjitha ZVRPP-ve.**

Me shkresë nr. *** prot., datë 20.04.2018, ZVRPP-ja Shkodër nuk jep informacion të plotë.

Me shkresë nr. *** prot., datë 25.05.2018, ZVRPP-ja Shkodër dërgon informacion shtesë.

➤ **Shkresë nr. *** prot., datë 27.03.2018, drejtuar noterit publik, znj. I.H.**

Noteri publik, znj. I.H., më datë 04.04.2018, na vë në dispozicion kontratën e shitblerjes, nr. *** rep., nr. *** kol., dhe akt heqje dorë nr. *** rep., nr. *** kol.

➤ **Shkresë nr. *** prot., datë 27.03.2018, drejtuar Entit Kombëtar të Banesave.**

Më datë 10.04.2018, me shkresë nr. *** prot., Enti Kombëtar i Banesave, na vë në dispozicion dosjen me informacionin e kërkuar.

➤ **Shkresë nr. ***, datë 07.02.2018, drejtuar të gjitha bankave të nivelit të dytë.**

“Raiffeisen Bank” me shkresë, nr. *** prot., datë 12.02.2018, na informon se, znj. I.S., ka llogari bankare pranë kësaj banke.

“BKT”-ja me shkresë, nr. *** prot., datë 22.02.2018, na vë në dispozicion informacionin e kërkuar.

“Tirana Bank” me shkresë, nr. *** prot., datë 15.02.2018, na vë në dispozicion informacioni e kërkuar por jo kopje të kredisë.

➤ **Shkresë nr. *** prot., datë 07.02.2018, drejtuar “OSHEE”-së.**

Me shkresë nr. *** prot., datë 28.02.2018, “OSHEE”-ja në vë në dispozicion informacionin e kërkuar.

shitur, më datë 21.07.2005, pra shumë kohë më vonë se kryerja e pagesës së apartamentit në pronësi të subjektit të rivlerësimit.

Për sa më sipër të ardhurat e siguruar nga shitja e apartamentit, me nr. pasurie *, ZK ***, Bashkia Shkodër, nuk do të konsiderohen si burim për blerjen e këtij apartamenti.**

1.2.3 Në lidhje me likuidimin e çmimit të apartamentit nga shqyrtimi i deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së tij në deklaratat e tyre periodike të interesave private të vitit 2004 dhe 2005 rezultojnë se:

- Bazuar në deklaratën periodike të interesave private të vitit 2004 të subjektit të rivlerësimit ai deklaron:
 - Paguar shuma 1,500,000 lekë dhe shuma 5.000 USD për prenotim apartamenti, dhjetor 2004.
 - Tërhequr shuma 500,000 lekë nga “Tirana Bank”, në dhjetor 2004.
 - Tërhequr shuma 5.000 USD nga “BKT” në dhjetor 2004.

I njëjti deklaram gjendet dhe në deklaratën periodike të interesave private të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit të vitit 2004.

- Bazuar në deklaratën periodike të interesave private të vitit 2005 të subjektit të rivlerësimit dhe të bashkëshortes së subjektit, ata deklarojnë si pasuri të shtuar, apartament më sipërfaqe 132.8 m² dhe si çmim blerje deklarojnë shumën prej 5,000,000 lekësh.

Për sa më sipër rezultojnë se çmimi i apartamentit është paguar në dy këste. Një kësht në dhjetor të vitit 2004 dhe kështin e dytë deri më datë 27.03.2005.

Për të vërtetuar aftësinë financiare të subjektit të rivlerësimit për blerjen e këtij apartament është kryer analiza financiare si më poshtë:

- **Analiza financiare viti 2004**

Në vitin 2004, subjekti i rivlerësimit, ka deklaruar se për blerjen e këtij apartamenti ka paguar paradhënie në shumën prej 1,500,000 lekësh dhe 5.000 USD, duke deklaruar si burim të ardhurash llogari kursimi pranë “Tirana Bank”, në shumën 500,000 lekë, dhe pranë “BKT”-së në shumën 5.000 USD.

Nga verifikimi i llogarive bankare rezultojnë se gjendet në këto llogari nuk kanë ndryshuar në fund të vitit, mbështetur në nxjerrjen e llogarive si më poshtë:

- **Znj. I.S.**

1) “BKT”

Nr.	Llog. bankare	Monedha	Viti 2002	Viti 2003	Viti 2004
1	Llog. Bankare, Nr. ***	USD	5.000	5.067.5	5.106,29

Bazuar në nxjerrjen e llogarisë pranë “BKT”-së, të znj. I.S., rezulton se shuma prej 5.106.29 USD në këtë llogari është tërhequr, më datë 10.01.2005.

2) “Tirana Bank”

Nr.	Llog. bankare	Monedha	Viti 2002	Viti 2003	Viti 2004
1	Depozite me afat ***	Lekë	460,000	499,305	533,321

Bazuar në nxjerrjen e llogarisë pranë “Tirana Bank”, të znj. I.S., rezulton se shuma prej 500,000 lekësh është tërhequr nga ana e znj. F.S.,² më datë 05.01.2005.

Në tabelën e mëposhtme, pasqyrohet situata financiare në fund të vitit 2004.

	Përshkrimi	Viti 2004
Nr.	Pasuritë	1,935,846
1	Apartament banimi, sip. 132,8 m ²	1,972,900
2	Shtuar/pakësuar gjendja e likuiditeteve në bankë	-37,054
Nr.	Të ardhurat sipas dokumentacionit	1,807,574
1	Paga e subjektit	799,489
2	Paga e bashkëshortes së subjektit	974,069
3	Interesa bankare	34,016
Nr.	Shpenzimet	335,000
1	Shpenzime jetike sipas ILDKPKI-së	335,000
	Analiza financiare	
1	Të ardhurat	1,807,574
2	Pasuritë	1,935,846
3	Shpenzimet	335,000
	Diferenca	-463,272

Siç rezulton edhe në analizën financiare të mësipërme subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme, në shumën prej 463,272 lekësh, për të likuiduar pagesën e paradhënies në vitin 2004 për blerjen e apartamentit.

• Analiza financiare viti 2005

Duke qenë se apartamenti është blerë në muajin mars të vitit 2005, analiza financiare do të kryhet për periudhën janar - mars 2005.

Situata financiare për blerjen e apartamentit, më datë 27.03.2005, është si më poshtë:

1) Gjendja e likuiditeteve në fillim të vitit 2005 “Tirana Bank”

1,016,274 lekë.

² Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se është një lapsus në emër, nga banka duhej të ishte I.S..

Znj. I.S., vlera (Depozitë me afat, nr. ***) “ BKT ” Znj. I.S., vlera 5106.29 USD	533,321 lekë. 482,952 lekë³
2) Të ardhurat, periudha 1 janar 2005 - 27 mars 2005,	379,729 lekë
- Paga e subjektit të rivlerësimit (891 574/12 muaj x 2,5 muaj),	185,745 lekë.
- Paga e bashkëshortes së subjektit (931 123/12 muaj x 2.5),	193,984 lekë.
3) Gjendje në llogari bankare	142,708 lekë.
“ Tirana Bank ”, datë 27.03.2005. Arben Zefi, I.S., “ Raiffeisen Bank ”, datë 24.03.2005. I.S., vlera	78,833 lekë. 33,321 lekë. 30,554 lekë.
4) Likuiduar blerja e apartamentit (4 355 840 - 1 972 900),	2,382,940 lekë.

Bazuar në tabelën e mësipërme rezulton se subjekti i rivlerësimit ka pasur një total të ardhurash në shumën prej 1,253,295 lekësh (të ardhurat nga paga e tij dhe e bashkëshortes në shumën prej 379,729 lekësh + të ardhurat nga llogaritë bankare në shumën prej 873,566 lekësh) ndërsa për blerjen e këtij apartamenti ka paguar shumën prej 2,382,940 lekësh.

Për sa më sipër subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme në shumën **1,129,645** lekë për të likuiduar vlerën e plotë të apartamentit, më datë 27.03.2005. **Në këtë analizë nuk janë llogaritur shpenzimet jetike.**

Nga ana e subjektit të rivlerësimit, në lidhje me konstatimet e mësipërme pas kalimit të barrës së provës, janë dhënë shpjegime të cilat Komisioni i vlerëson që nuk janë të mjaftueshme. Subjekti i rivlerësimit nuk ka dorëzuar asnjë dokument për të provuar deklaratimet e tij në lidhje me shlyerjen e kësteve në fillim të vitit 2005 dhe në fund të vitit 2005. Konstatimet e Komisionit janë bazuar mbi dokumente zyrtarë, si më poshtë:

- “Deklaratat Periodike të Interestave Private”, të vitit 2004 - 2005, të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së subjektit, të cilat në kuptim të 32/5 të ligjit nr. 84/2016, kanë cilësinë e provës.

³ Konvertuar me kursin e këmbimit 94.58 lekë/USD

- Kontratë shitblerjeje, nr. ***, datë 27.03.2005, në të cilën përcaktohet se **shuma prej 4,355,840 lekësh është likuiduar totalisht nga blerësi ndërsa pala shitëse pranoi se e mori të gjithë shumën dhe nuk paraqet asnjë pretendim për të.**

Referuar nenit 659 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë ku parashikohet se: “Kontrata është veprimi juridik me anë të së cilës një ose disa palë krijojnë, ndryshojnë ose shuajnë një marrëdhënie juridike”.

Nenit 660 të Kodit Civil ku parashikohet se: “Palët në kontratë përcaktojnë lirisht përmbajtjen e saj, brenda kufijve të vendosura nga legjislacioni në fuqi”.

Nenit 663 të Kodit Civil në të cilin përcaktohen kushtet e nevojshme për lidhjen dhe vlefshmërinë e kontratës, të cilat janë: “Pëlqimi i palës që merr përsipër detyrimin; shkak i ligjshëm në të cilin mbështetet detyrimi; objekti që formon lëndën e kontratës dhe forma e saj e kërkuar nga ligji”.

Nenit 690 i Kodit Civil ku parashikohet se: “Kontrata e lidhur rregullisht ka forcën e ligjit për palët. Ajo mund të priset ose të ndryshohet me pëlqimin e ndërsjellë të palëve ose për shkaqe të parashikuara me ligj”.

Në zbatim të dispozitave të mësipërme, ky trup gjykues vlerëson se nuk ekziston asnjë shkak ligjor që të vërë në dyshim vërtetësinë e fakteve të përshkruara në kontratat noteriale përfshirë këtu edhe likuidimin e çmimit të këtij apartamenti.

- Shkresat e ZVRPP-së Shkodër nga ku rezulton se apartamenti ka kaluar në pronësi të subjektit të rivlerësimit që **më datë 06.05.2005.**

Në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se si burim të ardhurash për blerjen e këtij apartamenti duhet të përfshihet dhe shuma prej 500,000 lekësh e tërhequr nga depozita e bashkëshortes së subjektit, Komisioni, konstaton se ky deklaram nuk është i saktë pasi bazuar në shkresën e ardhur nga “Tirana Bank”, rezulton se shuma prej 500,000 lekësh, ka qenë e vendosur në depozitë (nr. i llogarisë ***) dhe pasi është maturuar depozita, ka kaluar në llogarinë rrjedhëse (nr. i llogarisë ***) të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, e cila më datë 5.01.2005, ka tërhequr shumën prej 500,000 lekësh. Gjithashtu dhe shuma 1,900,000 lekë e përfituar nga shitja e banesës së subjektit të rivlerësimit nuk mund të konsiderohet si burim për blerjen e këtij apartamenti pasi shitja e kësaj banese është bërë më vonë se blerja e tij.

1.2.4 Subjekti i rivlerësimit përpara blerjes së këtij apartamenti me kontratë, nr. *** kol., datë 28.12.2001, ka blerë nga Enti Kombëtar i Banesave së bashku me z. E.Z., znj. Ç.Z., znj. L.Z., znj. T.Z., z. D.Z., znj. Z.Z., një apartament me sipërfaqe 56.1 m², me çmim 854,007 lekë.

Bazuar në pikën II të nenit të kontratës së shitblerjes me emërtim “Vleftha e apartamentit dhe çmimi i shitjes”, subjektit të rivlerësimit i takon shuma e përfitimit falas në vlerën 800,000 lekë⁴. Më datë 05.01.2002 nga ana e bashkëpronarëve të këtij apartamenti me aktin nr. *** është hequr dorë nga pjesa e tyre takuese ideale e pandarë duke e kaluar në favor të z. Arben Zefi.

⁴ Shih kontratën në dosje.

Bazuar në ligjin nr. 8030, datë 15.11.1995, “Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha”, çdo familje e pastrehë përfitonte falas të drejtën për të shpenzuar një shumë parash sipas përcaktimeve të këtij ligji e cila varej nga numri i anëtarëve të familjes, mosha si dhe kategoria e familjes së pastrehë⁵. Në zbatim të parashikimeve të këtij ligji, Enti Kombëtar i Banesave, ka llogaritur se subjektit të rivlerësimit i takonte një shumë prej 800,000 lekësh si përfitim nga ligji nr. 8030. Në këtë llogaritje Enti Kombëtar i Banesave është bazuar në certifikatën e datës 20.12.2001 të depozituar nga ana e subjektit të rivlerësimit ku përbërja familjare është si më poshtë:

E.Z., Ç.Z., L.Z., T.Z., D.Z., Arben Zefi, Z.Z., A.Z.

Nga ana e Komisionit i është kërkuar informacion subjektit të rivlerësimit për familjarët e tij. Në shpjegimet e tij ai sqaron se: *“Motra L.Z. është ndarë nga familja për shkak të martesës në vitin 1987. Vëllai, D.Z., është martuar në vitin 1992, fillimisht ka jetuar bashkë me familjen tonë dhe nga viti 2006 ka jetuar bashkë me bashkëshorten dhe fëmijët janë banues në Shëngjin ku edhe vazhdojnë të jetojnë aktualisht. Motra T. është ndarë nga familja për shkak të martesës në vitin 1992 dhe jeton në fshatin Balldre, Lezhë, bashkë me bashkëshortin dhe fëmijët e tyre. Pas blerjes së apartamentit prindërit kanë jetuar me mua dhe me vëllain A., i cili në tetor vitin 1996 filloi shërbimin e detyruar ushtarak, ndërsa motra Z. ka jetuar në Itali për shkak të studimeve. Në vitin 1997 kemi bërë ndarje familjare pasi prindërit e mi blenë në qytetin e Lezhës një apartament për vlerën 1,383,737 lekë. Kjo banesë është blerë për prindërit nga ana e motrës sime të madhe, L.Z.”.*

Mbështetur në deklaratimet e mësipërme të vetë subjektit, rezulton se familjarët e tij të përfshirë në llogaritjen e Entit Kombëtar të Banesave nuk kanë qenë anëtar të familjes së tij dhe rrjedhimisht ato nuk mund të përfshiheshin në llogaritjen e shumës që do të përfitonte subjekti i rivlerësimit në zbatim të ligjit nr. 8030. Gjithashtu bazuar në deklaratimet e subjektit të rivlerësimit dy prej motrave të tij kanë pasur shtëpi banimi dhe bazuar në ligjin nr. 8030 nuk plotësonin kriteret për të përfituar sipas këtij ligji.

Për sa më sipër rezulton se subjekti i rivlerësimit ka përfituar në kundërshtim me ligjin nr. 8030 shumën prej 800,000 lekësh nga Enti Kombëtar i Banesave.

Subjekti i rivlerësimit pas kalimit të barrës së provës deklaroi se në lidhje me motrat e tij nuk ka bërë deklaratim të saktë pasi është shprehur për të tashmen, ky deklaratim i tij nuk është i saktë pasi referuar përgjigjes së subjektit gjatë hetimit administrativ ai përgjigjet me data dhe vitet përkatëse. Gjithashtu ai nuk provon me dokumentacion provues që i takonte shuma prej 800,000 lekësh.

Më datë 04.01.2019, për të mbështetur deklaratimet e tij pas kalimit të barrës së provës, subjekti i rivlerësimit, ka depozituar aktshiteje, datë 08.04.1996, nga ku rezulton se znj. T.Z. ka blerë një truall me sip. 720 m². Në këtë kontratë rezulton se ky truall kufizohet në veri me pasurinë e znj. T.Z. duke konfirmuar në këtë mënyrë që, znj. T.Z., ka pasur në pronësi pasuri të paluajtshme.

⁵ Referuar ligjit nr. 8030, datë 15.11.1995, dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

Për sa më sipër subjekti nuk ka provuar me dokumentacion provues se atij i takonte të përfitonte shumën prej 800,000 lekësh duke marrë në konsideratë faktin, se bazuar në vet deklaratimet e tij, dy motrat kanë qenë të martuara në vitin 1992.

Apartamenti i mësipërm është shitur, më datë 21.07.2005, me kontratë nr. ***, për vlerën 1,900,000 lekë.

Shuma 1,900,000 lekë nuk rezulton e deklaruar në deklaratën “Vetting” nga ana e subjektit të rivlerësimit si detyrim ligjor i parashikuar nga aneksi D i Kushtetutës dhe nenet 30 - 32 të ligjit nr. 84/2016 si dhe nga ana e tij nuk është depozituar asnjë dokument për të vërtetuar pagimin e detyrimeve tatimore në zbatim të aneksit D të Kushtetutës. Është e paqartë se për çfarë janë përdorur paratë e përfituar nga shitja e këtij apartamenti duke e vënë subjektin e rivlerësimit në kushtet e deklaratimit të pamjaftueshëm.

Nga ana e subjektit të rivlerësimit në lidhje me këto konstatim pas kalimit të barrës së provës janë dhënë shpjegime duke na informuar se të ardhurat e këtij apartamenti janë përdorur për blerjen e apartamenti me sipërfaqe 132.8 m². Ky deklaram nuk përputhet me të dhënat e administruara gjatë hetimit administrativ pasi apartamenti me sipërfaqe 132.8 m² është blerë më herët se shitja e këtij apartamenti.

Komisioni, pasi shqyrtoi dhe analizoi shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit si dhe pasi e dëgjoi subjektin në seancë dëgjimore, arrin në përfundimin se:

- i. Subjekti ka bërë deklaram të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin, për shkak se nuk ka deklaruar burimin e të ardhurave për blerjen e apartamentit, me sip. 132.8 m², në deklaratën “Vetting”.
- ii. Subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar të ardhurat që kanë shërbyer për pagesën e këstit të parë dhe të dytë për blerjen e apartamentit me sipërfaqe 132.8 m², në shumë - 463,272 lekë, për vitin 2004 dhe në shumën - 1,129,645 lekë, në vitin 2005.
- iii. Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi duke mos deklaruar në deklaratën ‘Vetting’ të ardhurat në shumën 1,900,000 lekë të përfituar nga shitja e apartamentit me sip. 56.1 m².
- iv. Subjekti i rivlerësimit nuk shpjegoi bindshëm mënyrën e përdorimit të shumës 1,900,000 lekë. Ai nuk paraqiti dokumentacion ligjor justifikues që të provonin deklaratimet e tij.
- v. Subjekti i rivlerësimit nuk provoi me dokumentacion provues se atij i takonte të përfitonte shumën prej 800,000 lekësh nga Enti Kombëtar i Banesave në përputhje me legjislacionin në fuqi të kohës.

2. Automje, tip “BMW”, blerë në vitin 2007, me targa *. Nuk deklaron vlerën e blerjes.**

Burimi i krijimit sipas deklaratës “Vetting”:

Subjekti i rivlerësimit **nuk ka deklaruar burimin** e të ardhurave për blerjen e këtij automjeti detyrim i parashikuar nga Aneksi D i Kushtetutës dhe nenet 30 - 32 të ligjit nr. 84/2016.

2.1 Hetimi i kryer nga ana Komisionit⁶

2.2 Arsyetim ligjor

2.2.1 Subjekti i rivlerësimit në deklaratën “Vetting” në lidhje me këtë automjet ka deklaruar se e ka blerë në vitin 2007 por nuk ka deklaruar burimin e të ardhurave që kanë shërbyer për blerjen e këtij mjete, si dhe çmimin e tij.

Në lidhje me këtë konstatim, subjekti i rivlerësimit, pasi iu kalua barra e provës ka sqaruar se: *“Burimi i të ardhurave për blerjen e këtij mjete, për pjesën që unë kam shpenzuar, aq herë që ka ometim, nënkupton pagën time dhe të bashkëshortes, si të vetmet burime të ardhurash nga familja ime”*.

Ky deklarami i subjektit nuk e shmang atë nga detyrimi kushtetues për të deklaruar në deklaratën “Vetting” burimin e të ardhurave për blerjen e këtij mjete.

2.2.2 Bazuar në dokumentacionin e depozituar nga subjekti i rivlerësimit së bashku me deklaratën “Vetting” pranë ILDKPI-së për të provuar pronësinë e tij mbi automjetin, tip “BMW”, rezulton se ky automjet është blerë nga subjekti i rivlerësimit në qytetin e Milanos tek shoqëria “***”, më datë 29. 11. 2006, me çmimin në vlerën 3.000 euro, për zhdoganimin e tij është paguar shuma 315,303 lekë (shuma 173,928 lekë në formën e TVSH, më datë 25.09.2007, dhe shuma 141,375 lekë, më datë 25.09.2007, si tatim taksë).

Ndërkohë bazuar në dokumentacionin e administruar nga ana e Komisionit, me shkresë nr. * prot., nga DPSHTRR-ja rezulton se:**

- Referuar formularit import 4, datë 25.09.2007, çmimi i makinës është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në shumën 5.845 euro, ndërkohë në kontratën e blerjes çmimi është përcaktuar në shumën 3.000 euro.
- Referuar *e-mail* të datës 10.06.2010 të gjendur në dosjen e DPSHTRR-së ky mjet rezulton i vjedhur.
- Nga ana e DPSHTRR-së, me shkresë nr. *** prot., informohemi se mjeti është i çregjistruar.

➤ ⁶ Shkresë nr. ***, datë 07.02.2018, drejtuar DPSHTRR-së.

Me shkresë nr. *** prot., datë 14. 21. 2018, DPSHTRR-ja kthen përgjigje negative.

➤ Shkresë nr. *** prot., datë 27.03.2018, drejtuar DPSHTRR-së.

Me shkresë nr. *** prot., datë 05.04.2018, DPSHTRR-ja na informon se:

*Mjeti me targa *** është në statusin çregjistrim i përhershëm dhe ka qenë në pronësi të z. Arben Zefi.*

*Mjeti me targa *** është në pronësi të shtetases znj. I.S.*

*Mjeti me targë *** është në pronësi të z. A.H.*

Me shkresë nr. *** prot., datë 25.05.2018, Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor Durrës na vë në dispozicion dojsen e mjetit me targa ***.

Me shkresë nr. *** prot., datë 15.05.2018, DPSHTRR-ja na vë në dispozicion dosjen e mjeteve me targa *** dhe *** e paplotë.

2.2.2.1 Në lidhje me këtë automjet i është kërkuar informacion subjektit të rivlerësimit. Në përgjigjen e tij ai sqaron se:

*“Autovetura, tip “BMW 320”, është marrë në huapërdorje në vitin 2006 me premtimin për shitje nga një shtetas Kosovar me emrin Sh.S. të cilin e kishte kontaktuar vëllai i tij z. D.Z. Kontrata e huapërdorjes u bë pasi i dha shtetasit Sh.S. shumën 3.000 euro, dhe kontrata e shitjes do bëhej pasi ai të sillte çregjistrimin e mjetit nga Kosova. Pasi kaloi një vit nga përdorimi dhe me gjithë dështimet për të kontaktuar me pronarin e mjetit, i kërkoi vëllait të tij z. D.Z., i cili ishte edhe ndërmjetësi, që ta zgjidhte këtë problem sepse nuk mund ta mbante makinën në këtë regjim (huapërdorje). Më datë 21.09.2010, nga ana e policisë së Drejtorisë së Qarkut Shkodër është bllokuar mjete me targa ***, që e drejtonte z. A.Z., me dyshimin se ishte i vjedhur. Është bërë sekuestrimi i mjetit me vendim të prokurorit, më datë 22.09.2010, dhe prej asaj dite unë nuk e ka përdorur më mjetin. Mjeti është në sekuestro. I është thënë nga ana e prokurorisë nëse donte mjeti mund t'i lihej në ruajtje deri sa të zgjidhej çështja, por ai ka refuzuar. Subjekti i rivlerësimit deklaroi se ka paguar 3.000 euro për blerjen e mjetit ndërsa detyrimet doganore dhe çdo shpenzim për targim janë përballuar nga vëllai i tij z. D.Z. Subjekti i rivlerësimit deklaroi se prej datës 24.11.2010 që është i sekuestruar mjeti ai nuk ka bërë asnjë veprim në lidhje me këtë mjet”.*

Bashkëlidhur subjekti i rivlerësimit ka vënë në dispozicion dosjen e plotë të procedimit penal nr. ***, viti 2010 dhe vendimin e gjykatës nr. ***, datë 11.02.2011.

Nga analizimi i përgjigjes së subjektit të rivlerësimit dhe dokumentacionit të dërguar prej tij rezultoi se:

- Vëllai i tij shtetasi D.Z. është dënuar me vendim nr. ***, datë 11.02.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër e cila ka vendosur deklarimin fajtor të tij për veprën penale të falsifikimit të dokumenteve pikërisht për dokumentet e këtij mjeti.
- Subjekti i rivlerësimit bazuar në procesverbalin, “Për marrjen e të dhënave nga personi që ka dijeni për veprën penale”, të datës 04.10.2010, në lidhje me dokumentacionin e automjetit, tip “BMW”, që ka deklaruar se ka në pronësi në deklaratën “Vetting”, ka deklaruar si më poshtë:
“Jam i vetëdijshëm që për shkak të shmangies së pronarit të ligjshëm shtetasit kosovar, Sh.H., vëllai im në përpilimin e targimit të mjetit ka kryer veprime jo të ligjshme dhe tani që jam njohur me dosjen e targimit të mjetit konstatoj se ka akte të cilat nuk janë reale pra janë të falsifikuara. Kështu është plotësisht i falsifikuar akti i titulluar vërtetim hyrje Mjet i cili rezultoi në emrin tim”.

2.2.2.2 Subjekti i rivlerësimit së bashku me deklaratën “Vetting” ka depozituar dokumentet e mëposhtëm për të provuar pronësinë e tij mbi këtë mjet:

- Vërtetim nr. *** prot., datë 27.01.2017, Drejtorisë Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor Shkodër.

- Kontratë shitje mjete në shqip e shoqërisë “****” ku blerës rezulton, z. Arben Zefi, dhe çmimi i shitjes në shumën 3.000 euro
- Depozitë në *cash* nga z. Arben Zefi, më datë 25.09.2007, për pagesën e detyrimeve doganore të mjetit në shumën 173,928 lekë.
- Depozitë në *cash* nga z. Arben Zefi, më datë 25.09. 2007, për pagesën e tatim taksa të tjera në shumën 123 lekë
- Depozitë në *cash* nga z. Arben Zefi, më datë 25.09. 2007, për pagesën e tatim taksa të tjera në shumën 141,375 lekë.
- Depozitë në *cash* nga z. Arben Zefi, më datë 25.09. 2007, shuma 300 lekë.
- Vërtetim hyrje për automjetin, tip “BMW”, datë 24.09.2007, në emër të z. Arben Zefi.
- Kontratë shitje mjete e shoqërisë “****” ku blerës rezulton, z. Arben Zefi dhe çmimi i shitjes në shumën 3.000 euro

Të gjithë dokumentet e mësipërm bazuar në deklarinimin e subjektit të rivlerësimit në procesverbalin, “Për marrjen e të dhënave nga personi që ka dijeni për veprën penale”, të datës 04.10.2010, rezultojnë se janë të falsifikuara.

Për sa më sipër rezulton se subjekti i rivlerësimit gjatë procesit të rivlerësimit ka depozituar dokumentacion të pasaktë për të provuar pronësinë e tij për automjetin, tip “BMW” duke mos depozituar kontratën e huapërdorjes, nr. ***, datë 20.10.2006, e cila pretendohet si origjina për përfitimin e këtij mjeti.

Në lidhje me këtë konstatim, subjekti i rivlerësimit, pasi iu kalua barra e provës ka dhënë shpjegime të cilat do të merreshin në konsideratë vetëm në rastin kur dokumentacioni i automjetit do të paraqitej në përgjigjet e pyetësorit të Komisionit, ndërkohë ky dokumentacion është paraqitur pranë ILDKPI-së, bashkëlidhur deklaratës “Vetting”.

Për sa më sipër rezulton se subjekti i rivlerësimit ka përdorur dokumentacion të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin gjatë procesit të rivlerësimit (ka depozituar pranë ILDKPI-së dokumente të cilat rezultojnë të falsifikuara) për të provuar pronësinë mbi automjetin, tip BMW.

2.2.3 Deklarimi i subjektit të rivlerësimit në deklaratën “Vetting” në lidhje me vitin e blerjes (2007) nuk përputhet me deklarinimet e tij gjatë hetimit administrativ (deklarohet vit blerje 2006).

Pasi iu kalua barra e provës, subjekti i rivlerësimit, sqaron se:

“Nuk kam deklarime që nuk përputhen. Këto janë lapsuse ose gabime njerëzore. Unë e kam marrë në huapërdorje në vitin 2006 me targa të huaja dhe automjeti është targuar me targa shqiptare në vitin 2007.

Pas targimit, regjistrimit në Drejtorinë e Shfrytëzimit të Transportit Rrugor Shkodër është bërë deklarinim përpara organit shtetëror të regjistrimit të pasurive të luajtshme.

Këtë e kam deklaruar gjatë hetimit administrativ dhe deklarin e kam bërë në vitin 2007 pasi në këtë vit më ka kaluar në pronësi”.

Sqarimet e subjektit nuk janë bindëse dhe rrjedhimisht ai është në kushtet e deklarin të pasaktë të vitit të blerjes së këtij automjeti në deklaratën “Vetting”.

2.2.4 Subjekti i rivlerësimit deklaron se prej datës 24.11.2010 që është i sekuestruar mjeti ai nuk ka bërë asnjë veprim në lidhje me këtë mjet. Bazuar në të dhënat e “AMF”-së për këtë mjet janë prerë policat e sigurimit sipas periudhave të mëposhtme:

- 15.10.2008 - 14.10.2009.
- 16.04.2010 -15.04.2011, tek të dhënat e policëmbajtësit rezulton si përdorues z. S.Z.
- 08.04.2011 - 07.04.2012, tek të dhënat e policëmbajtësit rezulton si përdorues z. M.Gj.
- **Referuar shkresës nr. *** prot., datë 21.02.2014, të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Qarkut Lezhë, administruar me shkresë, nr. *** prot., datë 15.05.2018, të DPSHTRR-së rezulton se z. M.Z. (i cili është i vëllai i subjektit të rivlerësimit, z. D.Z., pasi ka ndryshuar emër), me vendim nr. **, më datë 24.02.2014, është gjobitur në shumën 2,500 lekë. Ky shtetas ka pasur leje qarkullimi për mjetin në pronësi të subjektit të rivlerësimit. Në këtë shkresë i kërkohet DRSHTRR-së Shkodër që të bëj bllokimin e veprimeve për z. Arben Zefi dhe z. M.Z. dhe për mjetin pasi nuk janë shlyer detyrimet financiare**

Nga këto të dhëna rezulton se automjeti, tip “BMW”, edhe pas sekuestrimit të tij është përdorur nga familjarë të subjektit të rivlerësimit si dhe ka vazhduar të jetë në pronësi të tij. Fakt që vërtetohet dhe me pasqyrimin e këtij automjeti nga ana e subjektit të rivlerësimit në deklaratën “Vetting” duke deklaruar se ka në pronësi automjet, tip “BMW”.

Për sa më sipër rezulton se ka mospërputhje midis deklarinëve të subjektit të rivlerësimit gjatë hetimit administrativ me dokumentet e administruara nga ana e Komisionit në lidhje me përdorimin e automjetit, tip “BMW”, pas vitit 2010 pasi ky automjet rezulton të ketë qenë në pronësi të subjektit të rivlerësimit edhe pas vitit 2010 pavarësisht faktit, që ka rezultuar i vjedhur si dhe është përdorur nga të afërm të tij të paktën deri në vitin 2014.

Në lidhje me këtë konstatim, subjekti i rivlerësimit, pasi i kaloi barra e provës ka dhënë shpjegime si dhe ka bashkëlidhur dokumentet e mëposhtme:

- Deklaratë noteriale nr. **, datë 19.12.2018, të shtetasit z. M.Gj. i cili deklaron se:

*“Një autoveturë të tipit “BMW”, me targë ***... e ka përdorur ai nga fundi i vitit 2010 - 2017 dhe më pas e ka ruajtur shtetasi B.D. nga Shkodra”.*

Ndërkohë kjo deklaratë noteriale nuk përputhet me:

- Urdhrin për “Lënë në ruajtje të provës materiale”, datë 19.04.2017, të paraqitur nga ana e subjektit të rivlerësimit nga ku rezulton se: *“Më datë 21.09.2012 nga forcat e policisë të seksionit kundër trafikëve të paligjshme pranë Drejtorisë së Policisë të Qarkut Shkodër është bërë sekuestrimi i automjetit, tip “BMW”, me targa *** ngjyrë gri. Në këto rrethana është bërë sekuestrimi i mjetit dhe në datën 21.09.2012 është lënë në ruajtje shtetasit B.D.,...”*
- Dokumentacionin e administrua gjatë hetimit administrativ nga ku rezulton se ky mjet është përdorur nga vëllai i subjektit të rivlerësimit në vitin 2014.

Për sa më sipër rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka dhënë deklarime të sakta gjatë hetimit administrativ të kryer nga ana e Komisionit në lidhje me përdorimin e automjetit, tip “BMW”, pas vitit 2010 si dhe e ka pasur në pronësi të tij këtë mjet pavarësisht faktit që ky mjet rezulton i vjedhur.

2.2.5 Nga verifikimi i deklaratave periodike të interesave private të subjektit të rivlerësimit rezulton se ai nuk ka deklaruar blerjen e këtij mjeti në shumën 3.000 euro në deklaratën e interesave private të vitit 2006 si dhe nuk ka bërë asnjë deklaram tjetër në deklaratat periodike të interesave private.

Në lidhje me këtë konstatim, subjekti i rivlerësimit, pasi i kaloi barra e provës sqaron se:

“Është e vërtetë, por ka lidhje faktin që këtë automjet e kam pasur në përdorim me kontratën, datë 20.10.2006 - kontratë huapërdorje, tek noteri A.K. Kur është targuar unë nga pakujdesia nuk e kam deklaruar në deklaratën periodike të interesave private të vitit 2007. Kjo pasaktësi e imja është konstatuar nga ILDKPKI-ja e cila ka ndërmarrë hetim administrativ, dhe pas hetimit administrativ ka konstatuar se nuk ka fshehje të pasurisë, deklaram të rremë apo burime të paligjshme. Unë këtë autoveturë e kisha regjistruar në regjistrat publik të pasurive të paluajshme në emrin tim, Drejtorinë e Shfrytëzimit të Transportit Rrugor dhe nuk kisha asnjë arsye për ta mosdeklaruar. Thjesht ka qenë harresë”.

Nga ana e subjektit të rivlerësimit pranohet fakti që blerja e këtij automjeti nuk është deklaruar në asnjë nga deklaratat periodike të interesave private.

Komisioni, pasi shqyrtoi dhe analizoi shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit si dhe pasi dëgjoi subjektin në seancë dëgjimore, arrin në përfundimin se:

- i. Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin në lidhje me pronësinë dhe vitin e blerjes së automjetit, tip “BMW”.
- ii. Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin, pasi nuk deklaruar blerimin e të ardhurave për blerjen e automjetit në deklaratën “Vetting”.

3. Automjet, tip “Mercedes Benz”, i ndërruar dhe i transferuar në Durrës, më datë 28.10.2014, por i pa çregjistruar akoma nga pronësia e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit. Blerë, më datë 22.09.2009, me targa ***. Nuk deklaroi vlerën e blerjes.

Burimi i Krijimit sipas deklaratës “Vetting”:

Subjekti i rivlerësimit **nuk ka deklaruar burimin** e të ardhurave për blerjen e këtij automjeti detyrim i parashikuar nga Aneksi D i Kushtetutës dhe nenet 30 - 32 të ligjit nr. 84/2016.

Automjet, “Volkswagen Passat”, në huapërdorje nga z. A.H., me targa *.**

3.1 Hetimi i kryer nga ana e Komisionit⁷

3.2 Arsyetim ligjor

3.2.1 Bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka blerë automjetin, tip “Mercedes Benz”, me kontratë shitblerje, nr. ***, datë 22.09.2009, për shumën 500,000 lekë.

Subjekti i rivlerësimit në deklaratën “Vetting” nuk ka deklaruar burimin e të ardhurave që kanë shërbyer për blerjen e këtij mjeti si dhe çmimin e tij. Në lidhje me këtë automjet subjekti ka deklaruar se e ka ndërruar dhe transferuar në Durrës, më datë 28.10.2014, por është i pa çregjistruar akoma nga pronësia e bashkëshortes së tij. Bazuar në shkresën nr. *** prot., datë 05.04.2018, të DPSHTRR rezulton se:

- Automjeti me targa ***, tip “Mercedes Benz”, ka pronar znj. I.S.
- Ky automjet bazuar në kërkesën e bërë nga, znj. A.R., është transferuar në Durrës, referuar vërtetimit për çregjistrimin e automjetit nr. *** prot., datë 28.10.2014, ndërkohë bazuar në kontratën e revokimit nr. ***, të datës 21.11.2014, rezulton se kontrata e shitjes për automjetin, tip “Mercedes Benz”, me targë ***, është revokuar.

Bazuar në të dhënat e “AMF”-së për këtë mjet janë prerë policat e sigurimit sipas periudhave të mëposhtme:

➤ **7 Shkresë nr. *** prot., datë 07.02.2018, drejtuar DPSHTRR-së.**

Me shkresë nr. *** prot., datë 14. 21. 2018, DPSHTRR-ja, kthen përgjigje negative.

➤ **Shkresë nr. *** prot., datë 27.03.2018, drejtuar DPSHTRR-së.**

Me shkresë nr. *** prot., datë 05.04.2018, DPSHTRR-së na informon se:

*Mjeti me targa *** është në statusin çregjistrim i përhershëm dhe ka qenë në pronësi të z. Arben Zefi.*

*Mjeti me targa *** është në pronësi të shtetasës, znj. I.S.*

*Mjeti me targë *** është në pronësi të z. A.H.*

Me shkresë nr. *** prot., datë 25.05.2018, DPSHTRR-ja na vë në dispozicion dosjen e mjetit me targa ***.

Me shkresë nr. *** prot., datë 15.05.2018, DPSHTRR-ja na vë në dispozicion dosjen e mjeteve me targa ***.

➤ **Shkresë nr. *** prot., datë 27.03.2018, drejtuar noterit publik, znj. P.B.**

Me shkresë datë 04.04.2018, noteri publik na vë në dispozicion revokim kontrate, nr. ***, datë 21.11.2014.

➤ **Shkresë nr. *** prot., datë 27.03.2018, drejtuar noterit publik, znj. V.H.**

Noteri publik, znj. V.H., në vë në dispozicion kontratë shitblerjeje, nr. ***, datë 22.09.2009.

➤ **Shkresë nr. *** prot., datë 11.07.2018, drejtuar DPSHTRR-së.**

Kthim përgjigje nr. *** prot., datë 02.08.2018, DPSHTRR-së.

- 09.06.2010 - 08.06.2011
- 08.06.2011 - 07.06.2012
- 08.06.2012 - 08.06.2013
- 10.06.2013 - 10.06.2014
- 10.06.2014 - 09.06.2015

Nga të dhënat e mësipërme rezulton se bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka prerë policë, TLP, për periudhën 10.06.2014 - 09.06.2015.

Për sa më sipër rezultoi se kishte mospërputhje midis deklarimeve të subjektit të rivlerësimit në deklaratën “Vetting” dhe hetimit administrativ, pasi automjeti, tip “Mercedes Benz”, ishte ende në pronësi të bashkëshortes së tij dhe se kontrata e shitblerjes me znj. A.R. e cila ka bërë kërkesën për transferimin e automjetit në qytetin e Durrësit është revokuar. Nga ana e subjektit të rivlerësimit gjatë hetimit administrativ është sqaruar se automjeti, tip “Mercedes Benz”, është ndërruar me automjetin, tip “Volkswagen Passat”.

Ky deklaram i subjektit të rivlerësimit nuk përputhet me deklaramin e tij në deklaratën “Vetting” ku ai deklaroi se këtë mjet e ka transferuar në Durrës, më datë 28.10.2014, dhe është ende i pa çregjistruar akoma nga pronësia e bashkëshortes së subjektit. Ndërsa për mjetin, tip “Volkswagen Passat”, ai deklaroi se e ka në huapërdorje, ndërkohë bazuar në deklaramet e tij automjeti, tip “Volkswagen Passat” është ndërruar me mjetin, tip “Mercedes Benz”.

Për sa më sipër rezulton se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm në deklaratën “Vetting” në lidhje me automjetin, tip “Mercedes Benz” dhe tip “Volkswagen Passat”.

3.2.2 Automjeti, tip “Volkswagen Passat”, është blerë nga shtetasi A.H., në Gjermani, për vlerën 7.000 euro. Bazuar në deklaratën doganore import 4, të datës 26.05.2014, detyrimet doganore kanë qenë në shumën prej 200,313 lekësh.

Këtë automjet e ka pasur në përdorim bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit me prokurë të posaçme, nr. ***, datë 29.08.2014. Nga përgjigjet e subjektit të rivlerësimit rezulton se ky automjet është shkëmbyer me mjetin, tip “Mercedes Benz”, dhe nuk është në përdorim të bashkëshortes së tij po në pronësi faktike të saj.

Ky konstatim mbështetet dhe në deklaratën noteriale, nr. ***, datë 12.10.2018, të dorëzuar nga ana e subjektit të rivlerësimit gjatë hetimit administrativ. Bazuar në këtë deklaratë rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e subjektit kanë shkëmbyer automjetin, tip “Mercedes Benz”, me automjetin, tip “Volkswagen Passat”, në pronësi të z. A.H.

Për sa më sipër rezulton se subjekti i rivlerësimit është pronari faktik i automjetit, tip “Volkswagen Passat” dhe ka humbur faktikisht pronësinë mbi automjetin, tip “Mercedes Benz”.

Në lidhje me këtë konstatim, subjekti i rivlerësimit, pasi i kaloi barra e provës ka dhënë shpjegime duke pranuar faktin që automjeti, tip “Volkswagen Passat” është në posedimin e bashkëshortes së subjektit dhe ajo sillet si pronare e mjetit dhe ndërkohë automjeti, tip “Mercedes Benz”, nuk është në posedimin e bashkëshortes.

Deklarimet e subjektit të rivlerësimit nuk përputhen me përmbajtjen e deklaratës noteriale nr. ***, datë 12.10.2018, të depozituar gjatë hetimit administrativ ku përcaktohet se: *“Ne të sipërshënuarit deklarojmë se automjeti, me targa ***, në pronësi të z. A.H. dhe automjeti me targa *** në pronësi të znj. I.S. i kemi këmbyer mjet më mjet pa pasur nevojë për diferenca në lekë”.*

Nëse krahasojmë vlerën e blerjes të automjetit, tip “Mercedes Benz”, në shumën 500,000 lekë dhe vlerën e blerjes së automjetit, tip “Volkswagen Passat”, në shumën 7.000 euro dhe detyrime doganore në shumën 200,313 lekë, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka shkëmbyer një automjet me vlerë 2-fish më të lartë se vlera e automjetit të tij.

Duke marrë në konsideratë faktin se z. A.H. është tregtar automjesh nga ky shkëmbim lindin dyshime të arsyeshme të një veprimi financiar të pajustificuar dhe të pambështetur në parimet e ekonomisë së tregut (*parimi i fitimit*), përderisa shitësi shet me një çmim më të ulët mallin.

Në lidhje me këtë konstatim, subjekti i rivlerësimit, pasi i kaloi barra e provës sqaron se:

*“Në kuptim të neneve 663, 676 dhe 607 të Kodit Civil, çmimi i përcaktuar në kontratën e shitjes nr. *** kol., datë 27.03.2005, përfaqëson vlerën reale të shitjes të sendit, veprimet kontaktuale janë kryer me vullnet të lirë dhe nuk ka pasur konflikt interesi”.*

Ndërkohë, më datë 08.01.2009, ai sqaron:

“Nuk është me vend që një marrëdhënie mes dy palëve të shihet nga një palë e tretë në këndvështrimin e interesit të saj. Në qoftë se marrëdhënia është në përputhje me legjislacionin, nuk cenon ligjin, parimet morale shoqërore dhe nuk cenon etikën e gjyqtarit dhe besimin e publikut tek drejtësia, nuk ka asnjë arsye që të paragjykohet. Për më tepër që një veprim juridiko-civil është ende i papërfunduar, dhe nuk mund të konsiderohet në ekstremitetet përkatëse apo të interpretohet pa realizim të plotë përkatëse”.

Shpjegimet e subjektit të rivlerësimit nuk janë bindëse dhe nuk mbështeten në prova për më tepër bazuar në deklaratën noteriale, nr. ***, datë 12.10.2018, rezulton se automjetet janë shkëmbyer përfundimisht dhe nuk jemi në kushtet e një marrëdhënie të mbetur pezull.

Nga verifikimi i deklaratave periodike të interesave private të subjektit të rivlerësimit rezulton se ai nuk ka deklaruar blerjen apo shitjen e automjetit, tip “Mercedes Benz” dhe shkëmbimin e automjetit, tip “Mercedes Benz”, me automjetin, tip “Volkswagen Passat”.

Në lidhje me këtë konstatim, subjekti i rivlerësimit, pasi i kaloi barra e provës ka dhënë shpjegime të cilat nuk janë bindëse dhe nuk mbështeten në prova. Pavarësisht faktit nëse shkëmbimi ishte bërë me akt noterial apo jo ai kishte detyrimin në zbatim të Aneksit D të Kushtetutës dhe neneve 30 -32 të ligjit nr. 84/2016, të deklaronte saktë në deklaratën “Vetting” të gjithë pasuritë e tij të luajtshme dhe të paluajtshme si dhe të drejtat reale mbi to.

Për sa i përket analizës financiare nëse subjekti ka pasur të ardhura të mjaftueshme për të blerë automjetin, tip “Mercedez Benz”, është bërë analiza financiare e mëposhtme.

Analiza financiare e vitit 2009

	Përshkrimi	Viti 2009
Nr.	Pasuritë	652,194
5	Autoveturë, tip “Mercedes Benz” A-180	500,000
7	LIKUIDITETE	152,194
Nr.	Detyrimet	-224,410
	Shlyerje këste kredie principal	-224,410
	Shlyerje këste principali (euro)	-1,636
Nr.	Të ardhurat sipas dokumentacionit	1,743,664
1	Paga e subjektit	1,020,479
2	Paga e bashkëshortes	723,185
Nr.	Shpenzimet	1,577,951
1	Shlyerje interesa të kësteve të kredisë	599,570
3	Shpenzime jetike sipas ILDKPKI-së	830,000
4	Shp. për udhëtime jashtë shtetit	76,815
5	Shumat e tërhequra ATM në TRENTO TR ENTO	71,566
	Diferenca	-710,891

Bazuar në analizën financiare rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme për të blerë automjetin, tip “Mercedes Benz”.

Pasi iu kaluar barra e provës, subjekti i rivlerësimit, ka dhënë shpjegime duke paraqitur një analizë financiare të re.

Subjekti i rivlerësimit nuk është i saktë në lidhje me shpenzimet jetike në analizën e tij ndërkohë ai në këtë analizë nuk ka përfshirë, shumën 224,410 lekë, e cila përbën detyrimin e shlyer nga ana e tij në lidhje me kredinë, gjithashtu në këtë llogari do të përfshihen dhe

shpenzimet në Trento dhe ato të udhëtimeve jashtë Shqipërisë. Përfundimisht subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme për blerjen e këtij mjete.

Komisioni, pasi shqyrtoi dhe analizoi shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit si dhe pasi dëgjoi subjektin në seancë dëgjimore, arrin në përfundimin se:

- i. Subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar të ardhurat që kanë shërbyer për blerjen e automjetit, tip “Mercedes Benz”.
- ii. Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin në deklaratën “Vetting” pasi nuk ka deklaruar shitjen/shkëmbimin e automjetit, tip “Mercedes Benz”, me automjetin, “Volksvagen Passat”.
- iii. Shkëmbimi i automjeteve i kryer nga subjekti i rivlerësimit përbën një veprim financiar të pajustificuar dhe të pambështetur në parimet e ekonomisë së tregut (parimi i fitimit), përderisa shitësi shet me një çmim më të ulët mallin e sapo blerë.

4. Në lidhje me likuiditetet

4.1 Hetimi administrativ i kryer nga Komisioni⁸

4.2 Arsyetim ligjor

4.2.1 Subjekti i rivlerësimit, më datë 20.07.2007, ka lidhur kontratë huaje, nr. ***, për nevoja personale.

Shuma është një shumë relativisht e madhe për t’u përcaktuar në kontratën e huas që do të përdoret për nevoja personale. Afati i kredisë 20.07.2007 - 20.07.2022.

Referuar nenit A, pika 4, të kontratës së huas rezulton se afati i kësaj kontrate është 15 vjet dhe jo 25 vjet siç ka deklaruar subjekti i rivlerësimit në deklaratën “Vetting”. Kredia është siguruar me kontratë hipotekimi, nr. ***, datë 20.07.2007, nëpërmjet së cilës është hipotekuar apartamenti i banimit në pronësi të subjektit të rivlerësimit. Referuar pikës 5.1 të kontratës së hipotekimit vlera e këtij apartamenti është 72.000 euro.

Vlera e pashlyer e kredisë bazuar në nxjerrjen e llogarisë të subjektit të rivlerësimit në fund të vitit 2016 është 25.378,66 euro.

➤ ⁸ Shkresë nr. *** prot., datë, 07.02.2018, drejtuar të gjitha bankave të nivelit të dytë.

“Tirana Bank” me shkresë, nr. ***, datë 15.02.2018, vë në dispozicion informacionin e kërkuar por jo kopje të kredisë.

➤ Shkresë nr. *** prot., datë 27.03.2018, drejtuar “Tirana Bank”.

“Tirana Bank” me shkresë nr. *** prot., datë 17.04.2018, na vë në dispozicion informacionin e kërkuar shoqëruar edhe me dosjen e kredisë.

➤ Shkresë nr. *** prot., datë 11.07.2018, drejtuar “Tirana Bank”.

Shkresë nr. *** prot., datë 27.07.2018, kthim përgjigje “Tirana Bank”.

Në lidhje me këtë kredi është pyetur subjekti i rivlerësimit i cili në përgjigjen e tij ka sqaruar se: “Në një bisedë me drejtorin e bankës (banka ku është klient për shkak të marrëdhënieve të punës, pasi kalon rroga aty), z. A.L., me të cilin ka edhe miqësi, ai i tregoi për një produkt financiar, kredi pa destinacion të përcaktuar, konsumatore, dhe mjaft preferenciale ku banka e emeton për klientë të saj, e jep menjëherë dhe jo me këste, dhe nuk kontrollon destinacionin e kredisë. Me bashkëshorten e mendova si një mënyrë për të akumuluar disa nga të ardhurat tona pasi ishim bërë me fëmijë dhe mendonin të shtonim familjen, por nuk po arrinim të kursenin nga të ardhurat e tyre. Nga këshilla që morëm, vlerësuam se duke marrë kredi mund të kapitalizojmë një pjesë të të ardhurave tona. Me bashkëshorten kishim të ardhura mjaft të mira, mbi 1.5 milion lekë në vit por nuk po arrinin të kursenim. Një mënyrë kursimi që menduan se është më e efektshme duke ia dhënë shoqërisë së ndërtimit “***” dhe për të përfituar sipërfaqe ndërtimi”.

Ky deklaram i subjektit nuk përputhet me të dhënat e administruara gjatë hetimit administrativ nga ku rezulton se nga ana e tij është tërhequr vetëm shuma 45.000 euro ndërkohë shuma 5.000 euro është shpenzuar në Itali. Në deklaratën e interesave private të vitit 2007, subjekti i rivlerësimit, nuk ka deklaruar se i ka dhënë shumën 50.000 euro shoqërisë “***”. Dhënie e kësaj shume shoqërisë “***” sh.p.k., nuk rezulton të jetë deklaruar në deklaratën “Vetting” si një detyrim ligjor i parashikuar nga Aneksi D të Kushtetutës dhe nenet 30 - 32 të ligjit nr. 84/2016. Nga analiza financiare e mëposhtme rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme për dhënien e shumës 50.000 euro shoqërisë “***” sh.p.k.

Analiza financiare e vitit 2007

	Përshkrimi	Viti 2007
Nr.	Pasuritë	5,803,708
1	Aktmarrëveshje për pasuri të paluajshme (e padeklaruar\0)	6,045,500
2	LIKUIDITETE	-241,792
Nr.	Detyrimet	5,847,405
1	Kredi në “Tirana Bank”	6,045,500
2	Shlyerje këste kredie principal	-196,470
3	Shlyerje këste principali (euro)	-1,625
Nr.	Të ardhurat sipas dokumentacionit	1,688,798
1	Paga e subjektit	908,258
2	Paga e bashkëshortes	780,540
Nr.	Shpenzimet	1,833,779
1	Shlyerje interesa të kësteve të kredisë	506,492
2	Shpenzime jetike sipas ILDKPKI-së	510,000
3	Shp. për udhëtime jashtë shtetit	25,996
4	Shumat e tërhequra ATM në TRENTO TR ENTO	791,291
	Diferenca	-101,284

Në lidhje me këto konstatime, subjekti i rivlerësimit, pasi iu kalua barra e provës ka dhënë shpjegime të cilat nuk janë të mbështetur në prova. Ai nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme për dhënien e shumës 50.000 euro shoqërisë “****” për sa kohë vlera 5.000 euro e kredisë është përdorur në Trento.

Subjekti i rivlerësimit kishte detyrimin ligjor që dhënien e shumës 50.000 euro shoqërisë “****” ta pasqyronte në deklaratën “Vetting”. Deklarimi i tij se ka deklaruar si detyrime në bankë nuk mund të merret si rrethanë për të përjashtuar subjektin e rivlerësimit nga detyrimi për të deklaruar në deklaratën “Vetting” dhënien e shumës 50.000 euro shoqërisë “****” sh.p.k.

4.2.2 Bazuar në shkresën ardhur nga “Tirana Banka”, rezulton se:

4.2.2.1 Më datë 27.05.2005, subjekti i rivlerësimit ka krijuar depozitë me afat me shumën 200,000 lekë dhe në datë 6 janar 2006 ka krijuar një depozitë tjetër me afat për shumën 500,000 lekë.

Në vitin 2007 ai ka mbyllur depozitën në shumën 200,000 lekë dhe ka zvogëluar depozitën në shumën 500,000 lekë duke ngelur shuma prej 300,000 lekësh. Në vitin 2011 e mbyll depozitën në shumën 300,000 lekë. Më datë 28 gusht 2012 hap sërish depozitë në shumën 300,000 lekë. Në prill të vitit 2013 këtë depozitë e kalon në depozitë për kartë.

Depozita aktuale në shumën 300,000 lekë nuk është deklaruar në deklaratën “Vetting” nga ana e subjektit të rivlerësimit si një detyrim i parashikuar nga Aneksi D të Kushtetutës dhe nenet 30 - 32 të ligjit nr. 84/2016. Gjithashtu depozitat e mësipërme nuk rezultojnë të jenë deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratat periodike të interesave private.

Në lidhje me këtë konstatim subjektit të rivlerësimit pasi i kaloi barra e provës ka dhënë shpjegime të cilat nuk janë bindëse pasi ai kishte detyrimin ligjor që të deklaronte në deklaratën “Vetting” depozitën në shumën prej 300,000 lekësh.

4.2.2.2 Subjekti i rivlerësimit ka llogari në lekë pranë “Tirana Banka” me gjendje, në vlerën 598,607.06 lekë, e cila nuk rezulton e deklaruar në deklaratën “Vetting” si një detyrim i parashikuar nga aneksi D i Kushtetutës dhe nenet 30 - 32 të ligjit nr. 84/2016.

Gjithashtu gjendjet në fund të vitit të kësaj llogarie të cilat kanë qenë relativisht të larta nuk janë deklaruar në deklaratat periodike të interesave private.

Në lidhje me këtë konstatim, subjekti i rivlerësimit, pasi i kaloi barra e provës ka dhënë shpjegime të cilat nuk janë bindëse, ai kishte detyrimin që në deklaratën “Vetting” të deklaronte këtë llogari bankare dhe gjendjen e saj duke marrë në konsideratë faktin se kemi të bëjmë me një shumë relativisht të madhe.

4.2.3 Nga nxjerrja e llogarisë së pagës së subjektit të rivlerësimit pranë “Tirana Bank”, rezulton se:

Nga viti 2006 - 2009 llogaria e pagës në lekë dhe ajo në euro rezulton të jetë përdorur në Itali nga një person i tretë.

Në lidhje me këtë konstatim është pyetur subjekti i rivlerësimit. Në përgjigjen e tij ai sqaron se: *“Përdorues i kartës sime të debitit ka qenë, A.E.Z., vëllai im i cili në atë kohë ndiqte studimet në Universitetin e Trentos, Itali, në jurisprudencë. Ai është ndihmuar shumë nga motra Z.E.W. (Z.E.Z.) e cila jeton në USA (praktikisht ka financuar shkollimin e tij) dhe më është kërkuar ndihmë për të përdorur kartën time të debitit në vlerën maksimale 300 euro në muaj për një periudhë kohe. Motra ime Z.E.Z. me bashkëshortin Z. J.D.W. u transferuan nga Los Angeles në Washington DC dhe kishte vështirësi në garantimin e pagesave, për shkollimin e vëllait, prej bankës së saj në Los Angeles, dhe përdorimi i kartës sime i jepte sigurinë e tërheqjes sistematike për çdo muaj për studime.*

Të gjitha paratë e marra në llogarinë time nga vëllai janë paguar nga motra ime Z.E.Z. Unë nuk kam pakësuar e shtuar pasuri, thjeshtë kam qenë në një marrëdhënie familjare normale”.

Ky deklaram i subjektit të rivlerësimit nuk mbështet në asnjë dokumentacion provues për më tepër nga ana e tij nuk është deklaruar në asnjë prej deklaratave të interesave private periodike por dhe në deklaratën “Vetting” përdorimi i kartës nga ana e z. A.Z. si dhe rimbursimi i shumave të marra nga ana e tij nga motra znj. Z.W.

Është e paqartë se cila ka qenë arsyeja që motra e subjektit të rivlerësimit nuk i ka lënë në përdorim kartën e saj të debitit, z. A.Z., apo ti transferonte shuma parash ashtu siç ka vepruar me babain e subjektit të rivlerësimit në vitin 2008 dhe vitin 2009.

Në lidhje me këto konstatime, subjekti i rivlerësimit, pasi i kaloi barra e provës ka dhënë shpjegime si dhe ka bashkëlidhur:

- Deklaratë e motrës së subjektit, znj. Z.W., datë 21.12.2018, cila deklaron se ka rimbursuar të gjitha shpenzimet e përdorimit të kartës së debitit të vëllait të saj Arben Zefi nga vëllai i saj A.Z.
- Deklaratë zëvendësuese e aktit noterial, datë 17.12.2018, nëpërmjet së cilës z. A.Z. deklaron se karta e debitit e subjektit të rivlerësimit është përdorur nga ana e tij dhe pa asnjë barrë për subjektin e rivlerësimit pasi shumat e tërhequra ishin mbuluar nga motra e tij znj. Z.W.

Komisioni çmon se të dy deklaratat e dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit, nuk kanë fuqi provuese në kuptim të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 86/2014, pasi ato nuk shoqërohen me asnjë dokument provues për mënyrën e lëvrimin dhe të përfitimit të rimbursimit nga subjekti i rivlerësimit të shumave të përdorura nga z. A.Z. dhe të rimbursuara nga motra e tij. Gjithashtu, Komision vlerëson se nuk mund të provohen veprime të ndodhura më shumë

se 10 vite më parë me deklarata të vitit 2018 për sa kohë këto veprime nuk rezultojnë të deklaruara nga ana e subjektit të rivlerësimit në deklaratat periodike të interesave private të cilat bazuar në nenin 32/5 të ligjit nr. 84/2016 kanë vlerën e provës por dhe në deklaratën “Vetting”.

Për sa më sipër, Komisioni, konkludon se për sa kohë subjekti i rivlerësimit nuk arriti të dokumentojë rimbursimin e shumave të përdorura në Itali nga motra e tij, këto të shuma do të konsiderohen si shpenzime në analizën financiare

Nga ana e Komisioni është kryer analizë financiare për vitin 2006 - 2009 nga ku rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme për vitet 2006, 2007 dhe 2009 për të mbuluar shpenzimet e kryera në Trento nga ana e personit të tretë (i cili sipas subjektit të rivlerësimit është vëllai i tij, z. A.Z.)

Analiza financiare viti 2006 - 2009

	Përshkrimi	Viti 2006	Viti 2007	Viti 2009
Nr.	Pasuritë	640,268	5,803,708	652,194
4	Makinë, tip “BMW”	371,109		0
5	Autoveturë, tip “Mercedes Benz” A-180	0	0	500,000
6	Aktmarrëveshje për pasuri të paluajtshme	0	6,045,500	0
7	LIKUIDITETE	269,159	-241,792	152,194
Nr.	Detyrimet	0	5,847,405	-224,410
1	Kredi në “Tirana Bank”	0	6,045,500	0
	Shlyerje këste kredie principal	0	-196,470	-224,410
	Shlyerje këste principal (euro)	0	-1,625	-1,636
Nr.	Të ardhurat sipas dokumentacionit	1,761,860	1,688,798	1,743,664
1	Paga e subjektit	896,066	908,258	1,020,479
2	Paga e bashkëshortes	865,794	780,540	723,185
Nr.	Shpenzimet	1,311,970	1,833,779	1,577,951
1	Shlyerje interesa të kësteve të kredisë	0	506,492	599,570
2	Shpenzime për aredimin e shtëpisë	500,000	0	0
3	Shpenzime jetike sipas ILDKPKI-së	335,000	510,000	830,000
4	Shp. për udhëtime jashtë shtetit	160,566	25,996	76,815
5	Shumat e tërhequra ATM në TRENTO TR ENTO	316,404	791,291	71,566
	Diferenca	-190,378	-101,284	-710,891

Në lidhje me këtë konstatime, subjekti i rivlerësimit, pasi i kaloi barra e provës sqaron se:
“Absolutisht këto shpenzime janë përballuar nga motra ime Z.W. banuese në Los Angeles Caunty, Kaliforni SHBA dhe jo nga unë”.

4.2.4 Nga nxjerrja e llogarisë në USD të subjektit të rivlerësimit rezulton se, më datë 13.08.2007, i ka kaluar shuma 100.000 USD.

Shuma e mësipërme është tërhequr *cash*, më datë 13 dhe 15 gusht 2007, nga subjekti i rivlerësimit. Gjatë hetimit administrativ rezultoi se nuk ka asnjë dokument për të vërtetuar se çfarë ka bërë subjekti i rivlerësimit me këtë shumë. Është pyetur subjekti i rivlerësimit në lidhje me këtë konstatim. Në përgjigjen e tij ai sqaron se: *“Kjo shumë është transferuar nga shtetasi R.D., me kombësi shqiptare por që jeton në Kanada, mbi njëzet vjet. Ai është biznesmen dhe është përdorur llogaria e tij vetëm për transferimin e shumës pasi shumën e ka marrë përsëri ai”*.

Nga ana e subjektit të rivlerësimit nuk është depozituar asnjë dokumentacion provues për të provuar kthimin e shumës 100.000 USD, z. R.D., duke e vënë subjektin e rivlerësimit në kushtet e mosdeklarimit të shumës 100.000 USD në deklaratën “Vetting” dhe deklarimit të pamjaftueshme për destinacionin e kësaj shume.

Në lidhje me këtë konstatim, subjektit të rivlerësimit pasi i kaloi barra e provës, ka dhënë shpjegime dhe ka bashkëlidhur:

- Deklaratë e znj. N.K.D., e cila deklaron se:

Është në dijeni të plotë se bashkëshorti i saj, z. R.D., ka dërguar në Shqipëri pranë “Tirana Bank”, më datë 13 dhe 15 gusht 2007, shumën 100.000 USD... dhe e ka kaluar në llogari të z. Arben Zefi...

Kjo deklaratë nuk përputhet me të dhënat e administruar gjatë hetimit administrativ nga ku rezulton se shuma prej 100.000 USD është transferuar me një transfertë, më datë 13.08.2007.

- Deklaratë të z. R.D., më datë 25.12.2018, i cili deklaron se:

Shuma 100.000 USD është transferuar në llogarinë e subjektit të rivlerësimit për qëllim të blerjes së një prone dhe është transferuar sërish në llogarinë e tij pasi nuk u realizuar blerja. Gjatë periudhës që është bërë kjo transfertë ai ka qenë personalisht në Shqipëri.

Komisioni, çmon se të dy deklaratat e dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit, nuk kanë fuqi provuese në kuptim të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 86/2014, pasi ato nuk shoqërohen me asnjë dokument provues për të vërtetuar kryerjen e transferimit nga ana e z. R.D. tek llogaria e subjektit të rivlerësimit, kthimin e kësaj shume, z. R.D., dhe transferimin e saj nga ana e z. R.D. në llogarinë e tij. Nëse, z. R.D., do kishte për qëllim transferimin e parave në Shqipëri ai fare mirë mund ta realizonte këtë nëpërmjet hapjes së një llogaria bankare në Shqipëri në emër të tij ose mund t'i transferonte parat tek familjarët e tij apo të bashkëshortes së tij.

Gjithashtu, Komisioni vlerëson se nuk mund të provohen veprime të ndodhura më shumë se 10 vite më parë me deklarata të vitit 2018 për sa kohë këto veprime nuk rezultojnë të deklaruara nga ana e subjektit të rivlerësimit në deklaratat periodike të interesave private por dhe në deklaratën “Vetting”.

Komisioni, pasi shqyrtoi dhe analizoi shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit si dhe pasi dëgjoi subjektin në seancë dëgjimore, arrin në përfundimin se:

- i. Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin pasi nuk ka deklaruar dhënien e shumës 50.000 euro shoqërisë “****” sh.p.k., në deklaratën “Vetting”.
- ii. Subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar të ardhurat për dhënien e shumës 50.000 euro, shoqërisë “****” sh.p.k.
- iii. Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin pasi nuk ka deklaruar në deklaratën “Vetting”, shumën 300,000 lekë, në formën e depozitës pranë “Tirana Bank”.
- iv. Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin pasi nuk ka deklaruar në deklaratën “Vetting” gjendjen në llogarinë në lekë pranë “Tirana Bank”.
- v. Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm dhe të pasaktë në deklaratën “Vetting” në lidhje me përdorimin e të ardhurave të tij.
- vi. Subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar të ardhurat për të mbuluar shpenzimet e kryera në Trento nga ana e personit të tretë (*vëllai i tij*) për vitet 2006, 2007 dhe 2009.
- vii. Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin pasi nuk ka deklaruar marrjen e shumës 100.000 USD nga z. R.D. në deklaratën “Vetting” si dhe ka dhënë deklaram të pamjaftueshëm në lidhje me këtë shumë.

5. Në lidhje me pasuritë e padeklaruara

5.1 Bazuar në paragrafin 3 të aktmarrëveshjes, nr. *, datë 17.04.2010**, të depozituar nga subjekti i rivlerësimit pranë ILDKPI-së gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar rezulton se, z. F.N., në cilësinë e administratorit të shoqërisë “****” sh.p.k., deklaroi se, më datë 20.08.2007, i ka marrë, z. Arben Zefi, shumën 50.000 euro paradhënie për vazhdimin e punimeve të pallatit i cili po ndërtohet në: Lagjen: “****”, Rr. “****”, Shkodër.

Shuma e marrë do të kthehej në formën e pasurisë së paluajtshme e konkretisht me një sipërfaqe ndërtimi (banimi dhe shërbimi) duke llogaritur çmimin sipas koston së ndërtimit. Në këtë aktmarrëveshje subjekti i rivlerësimit deklaroi se: *“Unë Arben Zefi deklaroj se shumën prej 50.000 eurosh e kam marrë në formën e kredisë nga “Tirana Bank”, dega Shkodër dhe qëllimi i marrjes së kësaj kredie ka qenë pikërisht lidhja e kësaj marrëveshjeje”*.

Kjo marrëveshje dhe pasuritë që do të përfitoheshin prej saj nuk janë deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratat periodike të interesave private por as në deklaratën “Vetting” si një detyrim i parashikuar nga Aneksi D të Kushtetutës dhe nenet 30 - 33 të ligjit nr. 84/2016.

Në lidhje me këto konstatime është pyetur subjekti i rivlerësimit. Në përgjigjen e tij ai sqaron se: *“Mendon se nuk ka qenë detyrim ligjor deklarimi i kësaj marrëveshje. Marrëveshja nuk ka pasjellë detyrime për të tretët dhe nuk ka shtuar as nuk ka pakësuar pasurinë e tij. Kjo marrëveshje do të deklarohet vetëm në momentin që do të realizohet, ku pasuria e tij monetare të konvertohet në pasuri të paluajtshme. Marrëveshja nuk është finalizuar pasi nuk ka rënë dakord akoma. Ka premtimin e shoqërisë që në rast se nuk bien dakord për sasinë e sipërfaqes apo llojin e pasurisë së paluajtshme, shoqëria “****” sh.p.k., do të paguajë të gjithë kredinë dhe interesat bankare, në momentin që mbaron afati i kredisë tek “Tirana Bank” (korrik 2022)”*.

Subjekti i rivlerësimit bazuar në:

- 1. Paragrafin 1 dhe 5 të aneksit D të Kushtetutës.**
- 2. Nenin 3/11, 30 - 33 si dhe shtojcën 2 të ligjit nr. 84/2016.**

Kishte detyrimin ligjor për të deklaruar në deklaratën “Vetting”, marrëveshjen nr. ***, datë 17.04.2010, lidhur me shoqërisë “****” sh.p.k., si dhe pasuritë të paluajtshme në formën e një sipërfaqe ndërtimi (banimi dhe shërbimi) që do të përfitonte nga kjo marrëveshje. Njëkohësisht subjekti i rivlerësimit kishte detyrimin ligjor që këtë marrëveshje ta deklaronte në deklaratën e interesave private të vitit 2010, ndërkohë pagesën e shumës prej 50.000 eurosh shoqërisë “****” sh.p.k., nëse ajo është bërë në vitin 2007 ai duhej ta deklaronte në deklaratën e interesave private të vitit 2007.

Në lidhje me këtë konstatim, subjekti i rivlerësimit, pasi i kaloi barra e provës ka dhënë shpjegime të cilat nuk janë të mbështetur në prova dhe në ligj.

Subjekti i rivlerësimit deklaroi se shoqëria “****” sh.p.k., ka kthyer përgjigje në lidhje me marrëdhënien që ka pasur me të, ndërkohë pranë Komisionit nuk është administruar asnjë shkresë e shoqërisë “****”, kjo shkresë nuk rezultoi të jetë dorëzuar as nga subjekti i rivlerësimit. Pavarësisht këtij fakti argumentet e subjektit të rivlerësimit nuk janë bindëse si dhe nuk mbështeten në prova.

5.1.1 Subjekti i rivlerësimit, me vendim nr. ***, datë 11.04.2015, ka vendosur pranimin e padisë së shoqërisë “****” sh.p.k., me objekt: “Pavlefshmëri e titullit ekzekutiv, faturë energjie”.

Për arsye të marrëdhënies që subjekti i rivlerësimit kishte me shoqërinë “****” sh.p.k., e cila ende nuk kishte përfunduar, si dhe me ortakët e saj ku nga vetë subjekti i rivlerësimit në shpjegimet e tij deklarohet se: *Z. Arben E. Zefi, nuk ka marrë akoma asnjë sipërfaqe banimi*

ose shërbimi sepse nuk i ka pëlqyer ndërtimi dhe nga bisedat që kemi pasur, **pasi kemi marrëdhënie shumë të mira shoqërore**, ai duhet të kishte kërkuar dorëheqjen nga kjo çështje gjyqësore në bazë të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” por dhe në bazë të nenit 72⁹ të Kodit të Procedurës Civile.

Në lidhje me këtë konstatim, subjekti i rivlerësimit, pasi i kaloi barra e provës ka dhënë shpjegime të cilat nuk janë bindëse.

Në përfundim duke vlerësuar se:

1. Konflikti i interesit është gjendja e konfliktit mes detyrës publike dhe interesave private të një zyrtari, i cili duhet të kryejë në mënyrë të drejtë detyrat dhe me përgjegjësi.
2. Si dhe nisur nga rrethanat e çështjes dhe problematikat e hasura në lidhje me pasurinë në fjalë, të shpjeguara më lart në vendim.

Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit bazuar në nenin 72 të Kodit të Procedurës Civile duhet të kishte dhënë dorëheqjen nga gjykimi i kësaj çështjeje gjyqësore, duke u vetë përjashtuar paraprakisht nga procesi konkret vendimmarrës pasi ka qenë në kushtet e konfliktit të interesit duke gjykuar një çështje ku palë ka qenë shoqëria “****” sh.p.k., shoqëri më të cilën ai ka një marrëdhënie interesi e cila nuk është finalizuar ende.

Në këto kushte, Komisioni, çmon se subjekti ka cenuar figurën e gjyqtarit, duke ushtruar veprimtarinë e tij në kushtet e konfliktit të interesit. Në të njëjtën kohë ai ka cenuar besimin e publikut te një drejtësi e pavarur dhe e paanshme.

5.2 Me shkresë nr. * prot., datë 30.03.2018**, Drejtoria e ALUIZNI-t për zonat turistike na vë në dispozicion dosjen e aplikimit të, z. Sh.S., i cili është babai i bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, duke na informuar se nuk është emetuar leje legalizimi.

Nga dokumentacioni i administruar rezulton se, më datë 18.07.2013, z. Sh.S., ka aplikuar për legalizimin e një ndërtese 3-katëshe në Velipojë, plazh, me sipërfaqe 525 m². Më datë

⁹ Gjyqtari është i detyruar të heqë dorë nga gjykimi i një çështjeje konkrete kur:

1. ka interes në çështje ose në një mosmarrëveshje tjetër që ka lidhje me atë në gjykim;
 2. ai vetë ose bashkëshortja e tij është i afërt deri në shkallë të katërt apo krushqi deri në shkallë të dytë ose është i lidhur me detyrime birësimi apo bashkëjeton në mënyrë të përhershme me njërin nga palët ose nga mbrojtësit;
 3. ai vetë ose bashkëshortja e tij janë në konflikt gjyqësor ose në armiqësi apo në marrëdhënie kredie apo huaje me njërin prej palëve, ose njërin prej përfaqësuesve;
 4. ka dhënë këshilla ose ka shfaqur mendim për çështjen në gjykim apo ka marrë pjesë në gjykimin e çështjes në një shkallë tjetër të procesit, është pyetur si dëshmitar, si ekspert ose si përfaqësues i njërit apo tjetrit palë;
 5. është kujdestar, punëdhënës i njërit prej palëve, administrator ose ka një detyrë tjetër në një ent, shoqatë, shoqëri ose institucion tjetër që ka interesa për çështjen në gjykim;
 6. në çdo rast tjetër kur vërtetohen, sipas rrethanave konkrete, arsye serioze njëanshmërie.
- Kërkesa për heqjen dorë i paraqitet kryetarit të gjykatës përkatëse i cili vendos. Për deklarinimin e heqjes dorë të kryetarit të gjykatës së shkallës së parë vendos kryetari i gjykatës së apelit dhe për kërkesën e këtij të fundit vendos kryetari i Gjykatës së Lartë. Përmbajtja e kërkesës u njoftohet palëve.

02.11.2015, është depozituar kërkesa e znj. Sh.S. nëpërmjet së cilës depoziton dëshminë e trashëgimisë të të ndjerit Sh.S. Bazuar në dëshminë e trashëgimisë nr. ***, më datë 16.09.2015, rezulton se znj. I.S. trashëgon ¼ pjesë të barabartë të gjithë pasurive të luajshme apo të paluajshme të ndjerit Sh.S.

Nga ana e subjektit të rivlerësimit nuk është deklaruar në deklaratën “Vetting” fakti se znj. I.S. është bashkëpronare në ¼ pjesë takuese në pasurinë e mësipërme.

Në lidhje me këtë konstatim i është kërkuar informacion subjektit të rivlerësimit. Në përgjigjen e tij ai sqaron se: *Shtesa nuk është e ligjshme deri në legalizimin e saj. Autoriteti shtetëror nuk ka vendosur akoma në lidhje me këtë shtesë. Nëse ajo legalizohet dhe bashkëshortja e subjektit merr pjesë takuese, patjetër që do të deklarohet prej tij.*

Në lidhje me pasuritë e luajshme ose të paluajshme që ka përfituar bashkëshortja e subjektit nga dëshmia e trashëgimisë ai deklaroi se: *Ajo nuk ka përfituar asgjë deri më tani. E drejta për të kërkuar trashëgimin nuk parashkruhet prandaj nuk e kanë parë të arsyeshme të marrim asgjë deri më tani, për më tepër që është gjallë nëna e bashkëshortes. Një formë respekti sa të jetë gjallë znj. Sh.S.*

Deklarimet e subjektit të rivlerësimit nuk janë bindëse pasi ai kishte detyrimin ligjor për të deklaruar pjesën takuese të bashkëshortes së tij, të pasurisë së paluajshme ndërtesë 3-katëshe, ndodhur në zonën turistike Pulaj, Velipojë.

Gjithashtu dhe deklarimi i tij se nuk ka përfituar asgjë nga trashëgimia pasi ajo nuk parashkruhet nuk qëndron pasi bazuar në **nenin 316 të Kodit Civil**, parashikohet se: *“Trashëgimia është kalimi me ligj ose me testament i pasurisë (trashëgimit) të personit të vdekur, një ose më shumë personave (trashëgimtarë), sipas rregullave të caktuara në këtë Kod”.*

Në **nenin 330** të Kodit Civil, parashikohet se: *“Trashëgimi fitohet me vdekjen e trashëgimlënësit”.*

Në **nenin 331** të Kodit Civil, parashikohet se: *“Me çeljen e trashëgimit, trashëgimtarit i kalon edhe posedimi i trashëgimlënësit mbi pasurinë trashëgimore, pa qenë nevoja për të vënë dorë mbi atë”.*

Në **nenin 348** të Kodit Civil, parashikohet se: *“Cilësia si trashëgimtar dhe pjesët takuese në trashëgimi caktohen në dëshminë e trashëgimisë, të lëshuar nga noteri, pas paraqitjes së certifikatës së vdekjes së trashëgimlënësit, sipas rregullave të caktuara në këtë Kod dhe në ligjin për noterinë.*

Dëshmia e trashëgimisë ligjore lëshohet nga noteri i njësisë vendore ku ka pasur vendbanimin e fundit trashëgimlënësi. Kur vendbanimi i fundit i trashëgimlënësit nuk dihet, dëshmia e

trashëgimisë ligjore lëshohet nga noteri që ushtron veprimtarinë në njësinë vendore ku ndodhet e gjithë pasuria e tij ose pjesa kryesore e saj”.

Bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka përfituar në cilësinë e trashëgimtares së të ndjerit Sh.S., ¼ pjesë takuese të gjitha pasurive të tij të luajtshme dhe të paluajtshme dhe rrjedhimisht duhet të deklaronte në deklaratën “Vetting” çdo pasuri që ka përfituar në cilësinë e trashëgimtares së z. Sh.S. pavarësisht faktit nëse ka vënë dorë mbi to.

Subjekti i rivlerësimit, pasi i kaloi barra e provës ka dhënë shpjegime të cilat nuk janë bindëse pasi ai në zbatim të aneksit D të Kushtetutës dhe neneve 30 - 32 të ligjit nr. 84/2016 kishte detyrimin ligjor për të deklaruar këtë pasuri për sa kohë nëna e bashkëshortes së subjektit ka depozituar pranë ALUZINI-t dëshminë e trashëgimisë ku një ndër trashëgimtarët rezultojnë edhe z. I.S. Me depozitim të kësaj dëshmie tashmë aplikimi nuk do të jetë më në emër të z. Sh.S. por në emër të trashëgimtarëve të tij.

5.3 Nga të dhënat e “AMF”-së rezultojnë se subjekti i rivlerësimit ka prerë rregullisht polica sigurimi TLP për mjetin me targa ***, në të dhënat e policëmbajtësit subjekti i rivlerësimit rezultojnë pronar:

- 19.05.2009 - 18.05.2010
- 22.05.2010 - 21.05.2011
- 21.05.2011 - 20.05.2012
- ***
- 21.05.2011-20.05.2012

Bazuar në shkresën nr. *** prot., datë 10.10.2018, të DPSHTRR-së rezultojnë se, më datë 30.01.2012, me kontratë nr. ***, subjekti i rivlerësimit në cilësinë e përfaqësuesit të z. A.P., bazuar në prokurën e posaçme nr. ***, datë 11.05.2009, ka shitur automjetin, tip “BMW” me targa ***, të z. A.B., për shumën 130,000 lekë.

Në prokurën e posaçme, nr. ***, datë 11.05.2009, z. A.P., i ka dhënë subjektit të rivlerësimit vetëm të drejtën e përdorimit dhe jo të drejtën e disponimit mbi këtë send. Ky mjet bazuar në dokumentacionin e DPSHTRR-së rezultojnë se është zhdoganuar, më datë 12.05.2009, nga z. A.P. Bazuar në deklaratën import 4, rezultojnë se mjeti është blerë për vlerën 8.000 euro dhe detyrimet doganore janë në vlerën 613,061 lekë.

Nga të dhënat e mësipërme rezultojnë se mjeti i është dhënë në përdorim subjektit të rivlerësimit një ditë para se ai të zhdoganohej si dhe subjekti është sjellë me këtë mjet si pronar për sa kohë e ka shitur atë pa pasur të drejtën e shitjes.

Duke marrë në konsideratë faktin që ky mjet nuk është përdorur asnjëherë nga blerësi i tij, i është lënë në përdorim subjektit të rivlerësimit që në momentin e zhdoganimit si dhe ai e ka

shitur këtë mjet pa pasur tagrat e përfaqësimit, ngrihen dyshime të arsyeshme se subjekti i rivlerësimit ka pasur në pronësi të fshehur automjetin, tip “BMW”.

Në lidhje me këtë konstatim subjektit të rivlerësimit pasi i kaloi barra e provës ka dhënë shpjegime si dhe ka depozituar:

- Deklaratë noteriale, nr. ***, datë 18.08.2018, nëpërmjet së cilës shtetasi A.P. deklaroi se: *“E ka telefonuar, z. A.B., dhe kanë bërë pazar për çmimin e një makine BMW që e ka pasur lënë te servisi i tij dhe i ka thënë që prokurën e ka z. Arben Zefi...E ka përdorur dhe z. Arben Zefi se i pata lënë një prokurë për ta e përdorur dhe për ta shitur”.*
- Deklaratë noteriale, nr. ***, datë 19.12.2018, nëpërmjet së cilës shtetasi A.B. deklaroi se: *“...Në vitin 2009 A.P. ka lënë tek servisi i tij një autoveturë, tip “BMW”, me targa ***, këtë autoveturë e ka përdorur ai dhe nganjëherë Arben Zefi...Në fund të vitit 2012 ka realizuar shitjen tek noteri për këtë makinë por lekët ja ka dhënë A., kur ka ardhur, në verë”.*

Kjo deklaratë nuk mund të merret në konsideratë pasi në kontratën e shitblerjes deklarohet se çmimi është likuiduar jashtë zyrës noteriale.

- Prokurë e posaçme, nr. ***, datë 11.05.2009 ku parashikohet se: *“Njëherazi përfaqësuesi ka tagër dhe kompetencë që ta targojë e në vijim shesë tek çdo palë e tretë”.*

Kjo frazë nuk gjendet në të njëjtën prokurë të administruar nga ana e Komisionit gjatë hetimit administrativ me shkresë nr. *** prot., të DPSHTRR-së.

Për sa më sipër rezulton se prokura e paraqitur nga subjekti i rivlerësimit në përfundim të hetimit administrativ nuk përputhet me prokurën e përdorur nga ana e tij për shitjen e automjetit, tip BMW.

Nga ana e subjektit të rivlerësimit pas kalimit të barrës së provës, më datë 4.01.2019, është depozituar vërtetimi i fotokopjes me origjinalin e noteres O.K. e cila deklaroi se: *“Prokura nr. ***, datë 11.05.2009, siç do të vëreni është në dy kopje meqenëse në momentin e parë nga ana ime, noteres, për gabim material nuk është referuar e drejta e shitjes si tagër i deleguar, dhe në vijim në të njëjtën datë i njëjti përfaqësues më ka vënë në dukje saktësimin e vullnetit të tij duke e plotësuar këtë akt”.*

Ky deklaram i noteres nuk përputhet me të dhënat e administruara gjatë hetimit administrativ nga ku rezulton se në aktin e shitjes së kësaj makine i cili është përgatitur nga vetë noteri publik, znj. O.K., nuk është prokura e pretenduar e korrigjuar por prokura pa të drejtën e subjektit të rivlerësimit për të shitur këtë automjet.

Për sa më sipër rezulton se nuk ka korrigjim prokura pavarësisht deklarimeve të noterit.

Në përfundim, Komisioni, pasi analizoi deklaratimet e subjektit dhe provat e dorëzuar prej tij konkuldon se ai nuk arriti të provoi se kishte tagrat për të shitur automjetin, tip “BMW”.

5.4 Në deklaratën e interesave private të vitit 2003, subjekti i rivlerësimit, deklaroi pronësinë mbi një automjet, tip “BMW”, me targa ***, e pajisur në emrin e tij blerë, më datë 09.08.2002, për shumën 700,000 lekë.

Si burim për blerjen e këtij mjeti deklaroi shitjen e një mjeti tjetër, tip “BMW”, me targa ***. Është pyetur subjekti i rivlerësimit në lidhje me këtë mjet, në përgjigjen e tij ai ka dhënë sqarimet përkatëse duke vënë në dispozicion:

Kopjen e kontratës, nr. ***, datë 06.09.2003.

Ndërkohë subjekti i rivlerësimit nuk na informon se çfarë ka bërë me këtë mjet më tej. Ky mjet nuk rezultoi i deklaruar në asnjë nga deklaratat e mëposhme të interesave private të subjektit të rivlerësimit si dhe nuk rezultoi i deklaruar në deklaratën VETTING.

Komisioni, pasi shqyrtoi dhe analizoi shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit si dhe pasi dëgjoi subjektin në seancë dëgjimore, arrin në përfundimin se:

- i. Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin pasi nuk ka deklaruar në deklaratën “Vetting” marrëveshjen që ka pasur me shoqërinë “***”sh.p.k., për përfitimin e pasurive të paluajtshme.
- ii. Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin pasi ka dhënë deklaram të pamjaftueshëm në lidhje me marrëdhënien që ka me shoqërinë “****” sh.p.k.
- iii. Subjekti i rivlerësimit gjendet në situatën e konfliktit të interesit pasi ka shqyrtuar një padi të shoqërisë “****” duke qenë ende në marrëdhënie interesi me të.
- iv. Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin pasi nuk ka deklaruar në deklaratën “Vetting” pjesën takuese të bashkëshortes së tij në një godinë 3-katëshe ndodhur në Velipojë.
- v. Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin pasi nuk provoi se kishte tagrat e përfaqësimit për të shitur automjetin, tip “BMW”, me targa ***.
- vi. Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin pasi nuk ka deklaruar në deklaratën “Vetting”, automjetin me targa ***.

B. NË LIDHJE ME VLERËSIMI I FIGURËS

Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016.

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjekti të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me

qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuar në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016. Për këtë qëllim DSIK-ja fillimisht ka dërguar një raport me shkresën, nr. *** prot., datë 02.11.2017, për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016 me konstatim për përshtatshmërinë në vazhdimin e detyrës nga subjekti i rivlerësimit. Më datë 25.04.2018, DSIK-ja me shkresë nr. *** prot., ka depozituar raportin e përditësuar me informacione të organeve ligjzbatuese për rishikimin e figurës të subjektit të rivlerësimit. Sipas këtij raporti rezulton se:

“Disponohen të dhëna të vitit... ku subjekti i rivlerësimit përfshihet në veprimtari të kundërligjshme, shfaqur në formën e korrupsionit pasiv të gjyqtarit për në disa procese gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër.

Dyshohet se ka pasur kontakte të papërshtatshme....

...Është i përfshirë në veprime korruptive për një çështje penale duke marrë përsipër lirimin e një personi të akuzuar për disa vepra penale kundrejt përfitimit të një shume të caktuar parash.

...Një ndër personat e implikuar në dhënien e vendimeve gjyqësore është edhe gjyqtari Arben Zefi.

Bazuar në informacionet që disponohen në ngarkim të subjektit të rivlerësimit për implikimin e tij në veprimtari korruptive, në kohështrirje gjatë viteve përpara dhe gjatë periudhës së rivlerësimit, evidentohet kryerja e veprimtarisë së paligjshme në mënyrë të përsëritur gjatë ushtrimit të detyrës nga ana e subjektit të rivlerësimit, si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër.

Në vlerësim të informacioneve të siguruara nga autoritetet verifikuese për subjektin e rivlerësimit evidentohet fakti i mosdeklarimit nga ana e tij të kontakteve të papërshtatshëm që ka pasur me persona të përfshirë në krimin e organizuar.

Në këndvështrimin e përgjithshëm të kontrollit të figurës së një rasti publik në rastin e subjektit të rivlerësimit të dhënat që disponohen dhe çdo dyshim i arsyeshëm për kryerje apo moskryerje të veprimeve në kundërshtim me ligjin, në mospërbushje të rregullt të detyrës dhe kur këto veprime apo mosveprime sjellin përfitime material ose jomateriale të padrejta për vete si funksionar publik apo persona të lidhur me të, duke dëmtuar interesin e ligjshëm të shtetit, apo personave të tjerë, cenojnë figurën e tij, integritetin, shkallën e besueshmërisë dhe e bëjnë subjektin e rivlerësimit të mundshëm për t'u vënë nën presion nga strukturat kriminale.”

Si konkluzion, DSIK-ja ka konstatuar papërshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit, z. Arben Zefi.

Komisioni i bëri të ditur subjektit të rivlerësimit konstatimin e DSIK-së në lidhje me papërshtatshmërinë e tij për vazhdimin e detyrës dhe ai dërgoi shpjegimet e tij.

Më tej, Komisioni bazuar në provat që dokumentet që disponon dhe vlerësimin e çështjes në tërësi në lidhje me kriterin e figurës, arrin në përfundimin se konstatimet në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës nuk mund të konsiderohen si shkak për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit sipas nenit 61 pika 2 të ligjit nr. 84/2016, por këto konstatime mund të konsiderohen në vlerësimin tërësor të procedurave të kontrollit të figurës, sipas nenit 61.5 të ligjit nr. 84/2016.

V. VLERËSIMI TËRËSOR I ÇËSHTJES

Në vlerësimin tërësor të çështjes, mbështetur në provat, faktet dhe rrethanat që Komisioni disponon për kriterin e vlerësimit e pasurisë dhe kontrollin të figurës si dhe vlerësimin tërësor të procedurave, Komisioni arrin në përfundimin se:

A. Për vlerësimin e pasurisë, Komisioni, arrin në konkluzionin se:

1. **Për apartament banimi**, me sip. 132,8 m², ndodhur në, Rr. “****”, Shkodër subjekti i rivlerësimit:
 - Ka bërë deklaram të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin, për shkak se nuk ka deklaruar burimin e të ardhurave për blerjen e apartamentit, me sip. 132.8 m², në deklaratën “Vetting”.
 - Ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar të ardhurat që kanë shërbyer për pagesën e këstit të parë dhe të dytë për blerjen e apartamentit, me sip. 132.8 m², në shumë - 463,272 lekë për vitin 2004 dhe në shumën - 1,129,645 lekë për vitin 2005.
2. **Për apartament banimi**, me sip. 56.1 m², ndodhur në Shkodër, subjekti i rivlerësimit:
 - Ka paraqitur në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi duke mos deklaruar në deklaratën “Vetting” të ardhurat, në shumën 1,900,000 lekë, të përfituar nga shitja e apartamentit, me sip. 56.1 m².
 - Nuk shpjegoi bindshëm mënyrën e përdorimit të shumës prej 1,900,000 lekësh. Ai nuk paraqiti dokumentacion ligjor justifikues që të provonin deklaratimet e tij.
 - Nuk provoi me dokumentacion provues se atij i takonte të përfitonte shumën prej 800,000 lekësh nga Enti Kombëtar i Banesave në përputhje me legjislacionit në fuqi të kohës.
3. **Për automjetin**, tip “BMW”, blerë në vitin 2007, me targa ***, Shkodër, subjekti i rivlerësimit:

- Ka bërë deklarin të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin në lidhje me pronësinë dhe vitin e blerjes së automjetit, tip “BMW”.
- Ka bërë deklarin të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin, pasi nuk deklaruar burimin e të ardhurave për blerjen e automjetit në deklaratën “Vetting”.

4. Për automjetin, tip “Mercedes Benz” dhe automjetin, tip “Volkswagen Passat”, në huapërdorje nga, z. A.H., subjekti i rivlerësimit:

- Ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar të ardhurat që kanë shërbyer për blerjen e automjetit, tip “Mercedes Benz”.
- Ka bërë deklarin të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin në deklaratën “Vetting” pasi nuk ka deklaruar shitjen/shkëmbimin e automjetit “Mercedes Benz” me automjetin “Volkswagen Passat”.
- Shkëmbimi i automjeteve i kryer nga subjekti i rivlerësimit përbën një veprim financiar të pajustificuar dhe të pambështetur në parimet e ekonomisë së tregut (parimi i fitimit), përderisa shitësi shet me një çmim më të ulët mallin e sapo blerë.

5. Në lidhje me likuiditetet, subjekti i rivlerësimit:

- Ka bërë deklarin të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin pasi nuk ka deklaruar dhënien e shumës 50.000 euro shoqërisë “***” sh.p.k., në deklaratën “Vetting”.
- Ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar të ardhurat për dhënien e shumës prej 50.000 eurosh, shoqërisë “***” sh.p.k.
- Ka bërë deklarin të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin pasi nuk ka deklaruar në deklaratën “Vetting”, shumën 300,000 lekë, në formën e depozitës pranë “Tirana Bank”.
- Ka bërë deklarin të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin pasi nuk ka deklaruar në deklaratën “Vetting”, gjendjen në llogarinë në lekë pranë “Tirana Bank”.
- Ka bërë deklarin të pamjaftueshëm dhe të pasaktë në deklaratën “Vetting” në lidhje me përdorimin e të ardhurave të tij.
- Ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar të ardhurat për të mbuluar shpenzimet e kryera në Trento nga ana e personit të tretë (vëllai i tij), për vitet 2006, 2007 dhe 2009.
- Ka bërë deklarin të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin pasi nuk ka deklaruar marrjen e shumës 100.000 USD nga z. R.D., në deklaratën “Vetting” si dhe ka dhënë deklarin të pamjaftueshëm në lidhje me këtë shumë.

6. Në lidhje me pasuritë e padeklaruara, subjekti i rivlerësimit:

- Ka bërë deklarin të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin pasi nuk ka deklaruar në deklaratën “Vetting” marrëveshjen që ka pasur me shoqërinë “***” sh.p.k., për përfitimin e pasurive të paluajtshme.

- Ka bërë deklarin të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin pasi ka dhënë deklarin të pamjaftueshëm në lidhje me marrëdhënien që ka me shoqërinë “****” sh.p.k.
- Gjendet në situatën e konfliktit të interesit pasi ka shqyrtuar një padi të shoqërisë “*****” sh.p.k., duke qenë ende në marrëdhënie interesi me të.
- Ka bërë deklarin të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin pasi nuk ka deklaruar në deklaratën “Vetting” pjesën takuese të bashkëshortes së tij në një godinë 3-katëshe ndodhur në Velipojë.
- Ka bërë deklarin të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin pasi nuk provoi se kishte tagrat e përfaqësimit për të shitur automjetin, tip “BMW”, me targa ***.
- Ka bërë deklarin të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin pasi nuk ka deklaruar në deklaratën “Vetting” automjetin me targa ***.

B. Për vlerësimin e kontrollit të figurës, Komisioni, arrin në konkluzionin se:

Përfundimet e nxjerra nga raporti i DSIK-së dhe shqyrtimi i tij në tërësi, janë të pamjaftueshme për t’u konsideruar si shkaqe për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit sipas parashikimeve të nenit 61 pika 2 të ligjit nr. 84/2016, por ato merren në konsideratë në vlerësimin tërësor të çështjes së subjektit të rivlerësimit, sipas nenit 61, pika 5, të ligjit nr. 84/2016

VI. KONKLUZIONI PËRFUNDIMTAR

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, konstaton se subjekti nuk ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, si dhe në vlerësimin tërësor të çështjes së subjektit të rivlerësimit, rezulton se ai ka cenuar besimin e publikut.

Më datë 10.01.2019, ora 10:08, subjekti i rivlerësimit, ka paraqitur shkresën ku kërkon dorëheqjen nga detyra në bazë të nenit G të Aneksi të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të Vendim nr. 78, datë 12.12.2017, të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.

PËR KËTO ARSYE

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të nenit 58, pika 1, germa “c”, si dhe të pikës 3 dhe 5, të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Arben Zefi, gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.
2. Vendimi i arsyetuar me shkrim u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisionerit Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, më datë 10.01.2019.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Firdes Shuli
Kryesues

Etleda Çiftja
Anëtare

Roland Ilia
Relator

Olsida Goxhaj
Sekretare gjyqësore